



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË

STUDIME POSTDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZË MAGJISTRATURE:

**“TENTATIVA E VEPRËS PENALE ME VËSHTRIM TË
POSAÇËM NË KOMUNËN E TETOVËS”**

KANDIDATI:
SAQIP SELIMI

MENTORI:
Prof.Dr.ISMAIL ZEJNELI

Tetovë 2019

Përmbajtja

HYRJE	4
Metodologjia e hulumtimit	5
Qëllimi i hulumtimit.....	6
Struktura e Planit.....	7
KAPITULLI I PARË	9
1.KUPTIMI I TENTATIVËS SË VEPRËS PENALE	9
1.1 Vështrim të përgjithshëm mbi fazat e kryerjes së veprës penale	9
1.2 Vështrimi historik i institutit të tentativës	11
Rregullimi i institutit të tentativës sipas kanunit të Lek Dugagjinit	12
1.3 Nocioni dhe figura e tentativës së veprës penale sipas Kodit Penal të Maqedonisë.....	14
1.3.1 Qëllimi i Tentativës së Veprës Penale	18
1.3.2 Ndëshkimi i tentativës së veprës penale sipas Kodit Penal të Maqedonisë dhe aplikueshmëria e dënimit nga ana e gjykatës	19
1.4 Aspektet komperative tëtentativës sëveprës penale	21
1.4.1 Tentativa e veprës penale sipas kodit penal të kosovës.....	22
1.4.2 Ndëshkimi i tentativës sipas kodit penal të Kosovës.....	23
1.5 TENTATIVA E VEPRËS PENALE SIAPS KODIT PENAL TË SHQIPËRISË.....	24
1.5.1 Ndëshkimi i tentativës së veprës penale sipas Kodit Penal të Shqiprisë	25
KAPITULLI I DYTË	26
2.1 LLOJET E TENTATIVAVËS SËVEPRËS PENALE	26
2.1.1 Tentativa e plotë	26
2.1.2 Tentativa e metë	27
2.1.3 Tentativa e papërshtatshme	28
2.1.3.1 Tentativa me mjete të papërshtatshme.....	29
2.1.3.2 Tentativa papërshtatshme lidhur me objektin	30
2.1.3.3 Tentativa e papërshtatshme absolute dhe relative	30
2.1.4. Natyra juridike e tentativës së papërshtatshme	31
2.2 Tentativa e cilsuar	32
2.3 Veprat penale në të cilat nuk është e mundur tentativa	33
KAPITULLI I TRETË	35
3. DALLIMI I TENTATIVËS NGA FAZAT TJERA TË VEPRËS PENALE	35
3.1 Dallimi i tentativës së veprës penale nga përgaditja	35
3.2. Dallimi i tentativës së veprës penale nga vepra penale e plotë.....	38

3.3 RASTET E POSAÇME TË TENTATIVËS.....	38
3.4 Nocioni dhe natyra juridike e heqjes dorë nga tentativa e veprës penale	40
3.4.1 Heqja dorë vullnetare nga tentativa e veprës penale e kryer me bashkëpjesëmarrje ..	43
KAPITULLI I KATËRT	45
4. RASTET NGA PRAKTIKA GJYGJËSORE E TENTATIVËS SË VEPRËS PENALE DUKE PËRFSHIRË PROFILIN E KRYERSIVE TË VEPRAVE PENALE.....	45
Profili i kryersive të veprave penale të ngelura në tentativë.....	45
4.1 Rastete e paraqitura të tentativës së veprës penale në Prokurorin themelore në Tetovë.	48
4.2 Rastet e zgjidhura me Procedur Penale në gjykatën themelore në Tetovë	49
4.3 Evidenca statistikore nga Enti Statistikor Republikan	51
Përfundimi	54
BIBLIOGRAFIA	56

HYRJE

Ndërmjet njerëzve janë vendosur shumë raporte shoqërore, raporte këto të cilat janë të llojve të karaktereve të ndryshme.

Që këto raporte të funksionojnë në mënyrë të rregullt, shteti ka siguruar mbrojtjen e tyre nga veprimet kriminale me norma juridiko penale, pra me dispozita penale.

E drejta penale, si degë e legjislacionit pozitiv të një shteti dhe si pjesë e sistemit të shkencave juridike, është një sistem normash ligjore me të cilat përcaktohet se cilat veprime të njerëzve konsiderohen vepra penale dhe çfarë lloje të sanksioneve penale do tu shqiptohen kryesive të tyre. Ajo merret me kuptimin e veprës penale dhe të figurës së saj, me elementët përbërës të kësaj figure, të cilët janë faktorët kryesorë që shërbejnë si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale.

Me luftën kundër fenomenit penal merren edhe shumë degë të së drejtës, si kriminalistika, kriminologjia, penologjia edhe shumë degë të tjera. E veçanta për të drejtën penale është se ajo përcakton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta sipas të cilave një vepër mund të konsiderohet vepër penale, sanksionet që parashikohen për autorët e tyre, si dhe rrethanat e veçanta lehtësuese dhe rënduse që duhet të meren parasysh në procesin e caktimit të tyre rast pas rasti nga gjykata.

Duke përcaktuar veprën penale si veprim shoqërisht të rrezikshëm, të parashikuar me ligj, kjo degë e së drejtës pozitive është bazë për një luftë efektive kundër kriminalitetit. Kjo degë synon të vendosë përpara përgjegjësisë penale ato persona që kryenë vepra, të cilët plotësojnë kushtet e cekura më lartë dhe si rrjedhojë garanton ligjshmërinë në procesin penal.

E drejta penale si shkencë juridike dhe degë e së drejtës pozitive ndahet në dy pjesë: në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme.

Kjo ndarje është si rrjedhojë edhe e faktit se të gjitha kodet penale të shteteve bashkëkohore ndahen në pjesën e përgjithshme dhe të posaçme. Edhe Kodi Penal i RM-së është ndarë në dy pjesë.

1. Pjesën e përgjithshme e përbëjnë dispozitat e karakterit të përgjithshëm që u referohen veprave penale, përgjegjësisë penale dhe sanksioneve penale.

2. Pjesa e posaçme, e cila ka për objekt studimin e figurave konkrete të veprave penale të parashikuara në dispozita të veçanta të pjesë së posaçme, sidomos elementët përbërës të tyre, si dhe rrethanta lehtësuese dhe rënduese në të cilat kryhen veprat penale nga persona konkretë.

Një nga të arriturat në të cilat vihet në dukje kujdesi që tregon e drejta penale për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit të mbrojtur me Kushtetutë, Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe me akte të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare është dhe kontributi që ajo jep lidhur dhe me përcaktimin e fazave të kryerjes së veprës penale apo fazave paraprake të kryerjes së veprës penale. Faza kryesore dhe ndoshta më e rëndësishmja prej tyre, të cilën kamë trajtur në këtë punim shkencorë është “tentativa”.

Për të kryer një vepër penale, në rrugën e vet kriminale deri te realizimi i plotë i veprës penale, kryersi mundë të kaloj nëpër disa stade-faza. E para është faza e mendimit të sjelljes së vendimit për të kryer ndonjë vepër penale. Faza e dytë është faza e përgaditjes, marrja e veprimeve të jashtme, reale me të cilat autori krijon kushte për kryerjen e veprës. Pas përgaditjes pason faza e tretë, faza e tentimit, fillimit të veprimit për kryerje të veprës. Dhe në fund vepra mund të jetë e përfunduar.

Këto katër faza të kryerjes së veprës penale nuk janë të domosdoshme qetëshprehen në çdo rast. Nuk është e thënë që një vepër penale të kalojë nëkatër fazat për të arritur rrezultatit e dëshiruar. Ekziston mundësia që vepra të kryet pa u ndërmarrë ndonjëra nga fazat e lartëpërmendura.

Metodologjia e hulumtimit

Për njohjen dhe hulumtimin e tentativës si fazë e kryerjes së veprës penale, praktika i ka të njohura mangësit dhe kufizimet e tyre.

Për realizimin me sukses të këtij punimi kam përdorur metoda të ndryshme për përmbledhjen dhe analizën e të dhënave që kam paraqitur në këtë punim të magjistarurës të cilat do të përkojnë me realizimin e qëllimit përfundimtar të këtij hulumtimi.

- **Metoda historike dhe logjike**, këto metoda janë mjaftë të rëndësishme për një punim shkencor. Metoda historike është një metod sipas së cilës dukurit juridike penale

studiohen në zhvillimin e tyre historik. Ndryshe nga metoda historike metoda logjike dikton që dukurit të shpjegohen jo nga historia e tyre por nga ligjet e zhvillimit.

Krahas metodave të përgjithshme logjike (induksionit, deduksionit dhe përgjithësimit, në realizimin e këtij punimi shkencor, janë përdor edhe këto metoda të veçanta

- **Metoda komperative.** Përmes metodes komperative kemi fituar njohuri lidhur me trajtimin juridiko -penale të tentativës së veprës penale në legjislacione të rajonit.

- **Metoda e vrojtimit-observimit.** Përmes vrojtimit-observimit indirekt kemi studiuar mjaft lëndë dhe dosje të personave kryerës së tentativës së veprës penale në Gjykatën Themelore të Tetovës, të dhëna të rëndësishme lidhur me personalitetet e kryerësve, ditare dhe publikime.

- **Metoda statistikore dhe evidenca statistikore.** Aplikimi i metodës statistikore na ka bërë të mundur mbledhjen, përcjelljen dhe pasqyrimin e shumë të dhënave të cilat kanë të bëjnë me tentativën e veprës penale. Në këtë drejtim kam shfrytëzuar edhe metodën e modelit, të mesatarës dhe përqindjes. Gjatë hulumtimit shkencor të kësaj teme kam fituar të dhëna mjaftë të rëndësishme nga shfrytëzimi i evitencave statistikore nga Gjykata Themelore e Tetovës, pasi edhe vetë fukusimi im në këtë punim shkencorë pikëreferuese e ka Komunën e Tetovës.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi shkencor është që të hidhet paka shumë dritë mbi një çështje shumë të rëndësishme dhe shumë aktuale siç është tentative e veprës penale. Qëllimi i këtij punimi është studimi i gjithëanshëm i shumë çështjeve thelbësore që kanë të bëjnë me tentativën e veprës penale si dhe njohjen e kësaj çështje.

Po ashtu, si qëllimi i këtij hulumtimi dhe studimi është edhe dhënia e përgjegjësis për vëllimin e tentativës së veprës penale në periudhën e caktuar në Gjykatën Themelore të Tetovës.

Arsyeja kryesore që më ka shty të shkruaj këtë temë është, prezenca e lartë e tentativës së veprës penale në mesin tonë. Situata e viteve të fundit që determinon hulumtimin e kësaj problematike,

pasi qënëmesin tonëshpesh herëndodhin tentativa tëndryshme për tëkryer vepërr penale, nëkëtëproblematikë prezent ështëshumë numri i erët i rastëve.

Shpresoj qëky punim shkencor tëshërbej si burim dhe matiral i nevojshëm lidhur reth kësaj problematike tërëndësishme.

Struktura e Planit

Ky punim shkencor i masterit përmban pjesën hyrëse, katër kapitujt, përfundimin, rekomandimi dhe bibliografin.

Në kapitullin e parë në fillim kam dhënë një vëshrtim të përgjithshëm mbi fazat e kryerjes së vepres penale, gjithashtu kam spjeguar historikun e fazës së tentativës sipas kanunit të Lek Dugagjinit, më pas kam dhënë një sqarim të qartë vetëm njëres fazë për të cilën jam përcaktuar më gjërsisht ta shpejgoj për fazën e tentativës, nocionin e tentativës së vepër penale, për figuren e tentativës së veprës penale, kam spjeguar qëllimin e tentativës së kryerjes së veprës penale gjithashtu kam folur edhe për tenativën e veprës penale sipas Kodit penal të Shqipëris, Kosovës. Kam bërë krahasimin e tentativës së veprës penale sipas Kodit Penal të RM-së me Kodet Penale të tjera.

Në kapitullin e dytë flitet kryesishtë për llojet e tentativave të veprës penale, për tentativen e papërshtatshme dhe llojet e saj, për natyren juridike të tentativës së papërshtatshme, dhe në cilat vepra penale nuk është e mundur tentativa.

Në kapitullin e tretë kam bërë dallime të kësaj fazë të kryerjes së veprës penale me fazat tjera, gjëgjësishtë bëhet dallimi i tenativës së veprës penale nga përgaditja e veprës penale, dallimi i tenativës së veprës penale nga vepra penale e plotë , kam shqyrtuar rastet e posaçme të tenativës së veprës penale, në këtë kapitull kam spjeguar për heqjen dorë vullnetare nga tentativa e veprës penale, gjithashti kam spjeguar edhe për rastet e heqjes dorë të kryera në rastin e bashkëpjesëmarrjes.

Kapitulli i katërtë, kamë shqyrtuar rastet nga praktika gjygsore, kam analizuar rastet veç e veç.

Përfundimi i këtij punimi është konstatimi kryesor mbi kuptimin e tentativës së veprës penale si dhe një vështrim të posaçm për territorin e komunës së Tetovës.

Në fund të punimit është dhënë regjistri i bibliografisë që është përdorur për nevojat e këtij punimi të masterit.

KAPITULLI I PARË

1.KUPTIMI I TENTATIVËS SË VEPRËS PENALE

1.1 Vështrim të përgjithshëm mbi fazat e kryerjes së veprës penale

Vepra penale nga ana e dinamikës kohore, zhvillohet sipas njëkriteri kriminal kompleks dhe tëartikulluar nëfaza tëndryshme.

Në rrugën e vet kriminale (inter criminis) deri te realizimi i plotë veprës penale, kryerësi mund të kalojë nëpër disa faza. Në literaturë cekën katër faza. Këto faza janë:1) vendimi për të kryer vepër penale 2) veprimet përgaditore të cilat ndërmeren me qëllimin e kryerjes së veprës penale 3) fillimi i kryerjes së veprës penale, që mund të ngelë edhe në tentativë dhe 4) kryerja e veprës penale (vepra penale e përfunduar).¹

Këto katër fazat të kryerjes së veprës penale, siç do të shohim në vazhdim, nuk kanë rëndësi të njejtë për të drejtën penale.

Faza e parë është vendimit për të kryer ndonjë vepër penale, kjo fazë është e domosdoshme për kryerjes e deliktit me paramendim. Marrja e vendimit për kryerjen e veprës penale paraqet proces psikologjik, mendor të vullnetshëm. Pasi marrja e vendimit paraqet një proces të padukshëm, të brendshëm psikologjik, deri sa vendimi nuk shprehet në botën e jashtme, ajo nuk mund të jetë e ditur, prandaj vendimi nuk mund të jetë lëndë e represionit penalo-juridik. Sipas të drejtës sonë penale dhe të drejtave penale të shteteve bashkohore, në rast kurë personi vetëm ka vendosur për të kryer vepër penale, nuk mund të dënohet. Për të gjithë atë që njeriu e ka në mendje që zhvillon në psiqiken e tij sipas të drejtës penale bashkohore, nuk parashihet kurrfarë sanksioni penal. Kjo fazë paraqitet vetëm në rastin e kryerjes së veprës penale me dashje.

¹ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.168

Vetëm për atë që njeriu dëshiron apo ka vendos që të kryej vepër penale, nuk duhet të ndëshkohet, ngase pa marrë parasysh vendimin apo dëshirën për të kryer vepër penale, ato ndërkoh mund të ndryshohen.²

Faza e dytë është faza e përgaditjes, me veprimin përgaditor personi manifeston mendimet e veta ne botën e jashtme për te kryer vepër penale.³

Marrja e veprimeve të jashtme reale me të cilet autori krijon kushte për kryerjen e veprës. Veprimet përgaditore janë veprime me paramendim me të cilat kryersi krijon kushte, e lehtëson kryerjen e veprës. Veprimet përgaditore më së shpeshti konsistojn në furnizimin e mjeteve për të kryer veprën penale, menjanimin e pengesave që mos paraqesën vështërsi në arritjen e rezultatit të dëshiruar, arritje e marveshjeve, organizimin me të tjerët për të kryer veprën penale. Duke vertetuar të gjitha këta veprime përgaditore që i ka përgaditur subjekti, por të cilat nuk paraqesin veprim të kryerjes. Ligji cakton ndëshkim për subjektin.

Ka raste edhe pse merrën të gjitha veprimet përgaditore në bazë të vendimit për kryerjen e veprës penale, por subjekti për shkaqe të ndryshme heq dorë nga qëllimi për të kryer vepër penale.

Përgaditja e veprës penale me ligj mund të caktohet si vepër e posaçme penale apo me ligj mund të caktohet ndëshkimi për përgaditje të veprës së posaçme penale.⁴

Dallojmë dy lloje të veprave penale të përgaditjes: vepra e pavarur përgaditore dhe vepra e varur përgaditore.⁵

Pas përgaditjes pason faza e tentimit, fillimit të veprimit për kryerje të veprës penale. Për këtë fazë më gjësisht kam hulumtuar gjatë këti punimi shkencor, kjo fazë është pikareferuese e imja.

Në fund është vepra e përfunduar, vepra e kryer është forma e rregullt e veprës penale. Vepra e përfunduar e vetmja formë në të cilat paraqitet delikti nga pakujdesia

Për këto faza të kryerjes së veprës penale mund të flitet, vetëm te veprat penale të kryera me dashje. Të gjitha këto faza janë të mundëshme por jo të domosdoshme për kryerjen e veprës penale me paramendim. Egziston mundësia që vepra të kryeht pa u ndërmarrë veprimet përgaditore, p.sh. kur personi kryen vepër penale në afekt, kur personi aty për aty vendos të kryejë

² Salihu Ismet, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2003, fq 338

³ Po aty,

⁴ Kodi penal i RM-së

⁵ Kambovski Vllado, e drejta penale, Shkup, 20007 fq 323

vepër penale pa ndërmarrë veprimet përgaditore. Gjithashtu ka edhe disa vepra penale ku për shkak të natyrës së veprës penale, veprimet përgaditore nuk mund të ndërmerren.

1.2 Vështrimi historik i institutit të tentativës

Nga njëvështrim historik të institutit të tentativës jammunduar të paraqes sa mëqartë karakteristikat dhe ndryshimet që ka pasur ky institut për gjatë kohërave dhe viteve të ndryshme, që unë kam cilësuar faza të cilat mund të pasqyrojnë paka shumë rrjedhën e zhvillimit apo të ndryshimit të këtij instituti.

Në historinë e së drejtës penale, institutin e tentativës e hasim njëkohësisht me institutin e veprës penale. Nëse do t'i hedhim një vështrim historik të drejtës penale do të vinim re se fazat e veprimtarisë paraprake kriminale, apo fazat para kryerjes së veprës penale, janë dënuar në mënyra të ndryshme në kohë të ndryshme historike.

Në periudhën skllavopronare personi dënohej jo vetëm për veprën penale të kryer në mënyrë të plotë, por edhe për veprimtarinë paraprake kriminale.

E drejta skllavopronare dënonte përgaditjen dhe tentativën. Kjo e drejtë dënonte dhe mendimin e shprehur në botën e jashtme edhe pse ai nuk shoqërohej me ndonjë veprim konkret.

E drejta penale feudale, në përgjithësi dënonte njëllë sikur vepra penale të kish përfunduar, si përgaditjen ashtu dhe tentativën. Ajo dënonte shfaqjen e mendimit në botën e jashtme dhe shkonte më tej se e drejta skllavopronare. Sipas kësaj të drejte, personi dënohej edhe kur dishohej se në mendjen e tij kishte lindur një mendim që ishte në kundërshtim me interesat e klasës në fuqi, sidomos me dogmat fetare. Mjafton që dikush të dyshohej se nuk pajtohej me interpretimin zyrtar të dogmave fetare për të përfunduar i djegur në turmën e druve.⁶

Pas revolucionit francez të shek.XIX, ideologë të ndryshëm i shpallën luftë arbitraritetit të së drejtës penale feudale.

⁶Lorenc Danaj, Tema e Disertacionit, Raporti i se Drejtës Penale me të Drejtën Ndërkombëtare, Tiranë, 2012 fq. 18

Ata ngriten parimin “nullum crimen sine lege, siaps të cilit nuk mund të konsiderohej veper penale një vepër e cila nuk parashikohej si e tillë nga vetë ligji. Si një e arritut shumë e madhe e kësaj periudhe është edhe parimi se mendimi i shfaqur në botën e jashtme nuk mund të konsiderohej vepër penale dhe personi nuk mund të dënoej vetëm për shfaqjen e mendimit. E drejta penale e kësaj periudhe shpall se, faza përgaditjes së veprës penale, në pjesën më të madhe të rasteve ishte e padënushme.

Sipas saj, dënimi duhej të zbatohet, si rregull, vetëm atëher kur personi kishte tentuar të kryente një vepër e cila, sipas ligjit konsiderohej vepër penale.

Në viset shqiptare, nga fillimi shek. XV, nëpër vendet e pushtuara nga Perandoria Osmane vepronte Sheriati, i cili ishte i bazuar në Kuran. Karakteristikë në këtë kohë ishte përcaktueshmëria e dënimeve, të cialt mund ti ketë dhënë Kdiu sipas bindjës së tij, në mbrojtje të interesave të klases sunduese që ai përfaqëson.

Në viset shqiptare ky ligj zbatohet në qytete dhe në ato zona të cilat ishin të pushtuara nga Turqia, kurse në zonat malore, të cilat nuk iu nënshtruan administratës së huaj vazhdonte të vepronte e drejta zakonore penale e shqiptarëve.

Në historin e së drejtës zakonore, zakonet janë konceptuar si tërësi e normave të pashkruara, të përcjella në traditën nga njëri brez në tjetërin.

Burimet e së drejtës zakonore shqiptare të njohura deri tani jane: Kanunui i Skënderbeut, Kanuni i Lekë Dugagjinit, Kanuni i Malëve dhe Knuni i Labërisë.

Të gjitha këto Kanune pa përjashtim, parashikonin një varg normash më karakter penal, por ndër këto vend kryesor ka zënë Kanuni i Lekë Dugagjinit.

Rregullimi i institutit të tentativës sipas kanunit të Lek Dugagjinit

Sipas kanunit, veprat penale mund të kryhej si me veprime aktive ose me mosveprime. Për disa vepra penale kërkohej ardhja e pasojës, si p.sh. vdekja e viktimës në vërasje, kurse për të tjera, vepra penale mund të mbetej në tenativë⁷

⁷Ismet Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, Tiranë, 1998 faqe 22.

Lidhur me fazat e zhvillimit të veprës penale, Kanunet flisnin për përgaditjen, por për këtë fazë nuk parashikohej përgjegjësia penale. Si fazë e parë e kryerjes së veprës penale pranohej tentativa dhe pastaj vepra e kryer e përfunduar.

Tentativa dallohej në disa lloje:

- Kur një person qëllon me pushk një tjetër dhe plumbi i shkonte pranë, ai detyrohej të shpërblente gjysmën e gjakut,
- Kur një person qëllonte kundërshtarin, por pushka nuk i shkrephte, sepse fisheku nuk ishte i përshtatshëm, fajtori përgjegjej njëlloj si për krim të kryer,
- Kush qëllonte një kufomë përgjigjej për dy gjaqe për tentativë vrasje dhe për fyerje të të vdekurit.⁸

Kanuni i Lek Dugagjinit jepë këtë nocion lidhur me tentativën e veprës penale.⁹

Kështu në paragrafin 941 thuhet: “pushka e nisun ka gjobë pushka e parë ka gjobë”, paragrafi 942 thot: ”e shkrepnja ka gjobë”

Pavarishtë se vepra penale nuk është përfunduar e drejta zakonore penale mbronte mardhëniet shoqërore nga vepra e mbetur në fazën e tentativës, si dhe përcakton dënimin e përcaktur sipas rastit.

Kështu siaps Kanunit të Lek Dugagjinit kur një person qëllon me pushkë një tjetër dhe plumbi përshkaqe të pavarura prej tijë nuk shkonte pranë personit, ai nuk detyrohej të shlynte çmimin e gjakut për gjobën ose shpërblim për plagose, kur plagoste të dëmtuarin.

Pra personi ka kryer veprimet e nevojshme për të realizuar veprën, pavarishtë se për shkaqe që nuk vareshin prej tij, ai nuk ka mundur të përfundonte veprën, dhe si rrjedhim vepra ka mbetur në fazën e tentativës pavarishtë se nga veprimet e kryera nuk ka ardhur pasoja e dëshiruar, por mund të ketë ardhur një plagosje e lehtë.

Edhe kur pushka qëllonte kundërshtarin, por pushka nuk i shkrephte sepse fisheku nuk ishte në rregull, atëherë fajtori binte në gjak njëlloj sikur të kishte kryer krimin.

Pavarishtë nëse vepra mund të cilsohet si tetnativë me mjete të papërshtatshme, qëllimi i personit ka qen kryerja dhe përfundimi i plotë i veprës penale së nisur dhe si rrjedhoj personi do të dënohej për vepër penale të mbetur në fazën e tentativës.

⁸ Kanuni i Lekë Dugagjinit, i përmbledhur nga Shtjefën Gjeçovi

⁹ Po aty,

Po ashtu kush qëllonte kundër një kufome ai binte në dy gjaqe në njëren për njellosjen e të vdekurit dhe në tjetrën për tentativë vrasje.

Po kështu në rastin kurë një person shkon para shtëpisë së një tjetri dhe qëllonte me pushkë, megjithëse në shtëpi mund të mos kishte asnjë njeri por prap binte në gjakë, mbase kjo ishte një fyerje e rëndë drejtuar kundër nderit të zotit të shtëpi.

Nëse analizojmë dënimin që parashikonte Kanuni i Lek Dugagjinit për tentativën shumica dërmuese e tyre ishte me gjobë.

Kështu në paragrafin 906 thuhet:

Po qita mbi kënd edhe vetëm e gërvishta në krye, i kam 3 qese për varrë. Po i rashë kambës i kam 750 grosh, eshtimja në brez e përpjet ka 3 qese, në brez e poshtë ka 750 grosh.¹⁰

1.3 Nocioni dhe figura e tentativës së veprës penale sipas Kodit Penal të Maqedonisë

Figura e tentativës apo e veprës penale tëlënë në tentativë, manifestohet në ato raste kur subjekti veprës nuk arrin të realizojë deri në fund veprën penale të programuar apo ideuar. Përkufizimi i tentativës conatus delikti si një nga fazat e veprimtarisë paraprake të veprës penale ka zënë vend në kodin penal të RM-së.

Tentativa si përkufizim është dhënë në nenin 19 të Kodit Penal të RM-së. Tentativa ekziston kur dikush me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar.¹¹

Në literaturën juridiko penale, në lidhje me tentativën ekzistojnë disa teori, të cilat ndahen në teori objektive dhe teori subjektive.

Teoria objektive. Kjo teori, e ndan tentativën nga fazat e tjera të kryerjes së veprimtarisë kriminale nisur nga lloji i veprimeve objektive.

Përkrahsit e kësaj teorie e trajtojnë tentativën si aspekt që karakterizon vetëm anën e jashtme të veprimeve të subjekteve të veprës penale dhe nuk i referohen anës subjektive, domethënë qëndrimit psikik të autorit të veprës, kundrejt veprimeve të tij dhe pasojave që ai ka dëshiruar të arrijë.

¹⁰ Kanuni i Lek Dugagjinit, i përmbledhur nga Shtjefaën Gjeçivi

¹¹ Kodi Penal i RM-së, Shkup 2015

Teoria subjektive .Kjo teori ka për bazëpërfytyrimin subjektiv tëpersonit qërealizon krimin dhe jo cilësitëe veprimeve tëjashtme tëkryera. Sipas kësaj teorie me tentativëkuptohet veprimi kriminal i pakryer qëpërmbanëqëllimin e subjektit për kryerjen e veprës sëdënueshem. Nëse teoria objektive niset nga karakteri i veprimit nga ana e jashtme e tij, qëderi nënjëfar mase dallon tentativen nga përgaditja.

Tentimi është vepra e filluar por e pambaruar, sipas këtij përkufizimi, tentativa do të egzistojë në rastet kur vepra penale ka filluar të kryhet, mirëpo nuk është shkaktuar pasoja e dëshiruar. Tentativa është një fazë e veçnat e veprimtarisë kriminale.

Në këtë fazë personi që ka vendosur të kryjë një krim të caktuar është më afër kryerjes së plotë të krimit se në fazat tjera. Për shembull, personi X shkrepi me armë në drejtim të personit Y me qëllim që ta privojë nga jeta, mirëpo nuk e qëllon. Për tu konsideruar se është kryer tentativa e veprës penale, patjetër duhet të përmbushen këto tri kushte:1) që të ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale 2) që veprimi të ndërmerret me dashje dhe 3) vepra të mos përfundohet, përkatësisht që të mos shkaktohet pasoja e veprës penale.¹²

Nëse mungon njëra nga këto kushtet e lartëpërmendura atëherë nuk kemi të bëjmë me tentativë të veprës penale, atëherë vepra penale merë kahje tjetër apo kemi të bëjmë me ndonjë fazë tjetër të veprës penale p.sh. nëse shkaktohet pasoja e dëshiruar atëherë vepra penale është e përfunduar.

Pasi që këto tri kushtet janë të domosdoshme që vepra të quhet veprë e ngulur në tentativë , unë kam dhënë një sqarim të shkurtë për të tri kushtet.

a) Kushti i parë për egzistimin e tentativës së veprës penale është ndërmarrja e veprimeve të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale.

Nuk mund të ndodhemi përpara tentativës, kur akoma nuk janë krijuar kushtet që autori i krimit të vepronte drejtpërdrejtë mbi objektin. Para kësaj kohe jemi ende në veprimet përgaditor të subjektit. Por në momentin që ai vepron drejtpërdrejtë mbi raportin shoqëror të mbrojtur nga ligji penal, dhe nuk arrin të realizoj qëllimin e tij për shkak të pavarura nga vullneti i tij, ndodhemi përpara tentativës.

Çështja e përcaktimit të ndërmarrjes së veprimit të kryerjes së veprës penale, fillimit të kryerjes së saj ka rëndësi të madhe kriminalo politike, teorike dhe praktike. Rëndësia kriminalo

¹² Salihu Ismet, E drejta penale,pjesa e pergjithëshme, Prishtinë, 2003, fq.343

politike e përcaktimit të fillimit të veprimit të kryerjes qendron në faktin se me këtë caktohet kufiri midis asaj që nuk është e ndëshkuar dhe veprimet përgaditore dhe asaj që është e ndëshkuar veprimi i kryerjes së veprës penale. Ky është momenti për të cilin interesohet dhe e drejta penale. Momenti i ndërrmarjes së këtyre veprimeve ka rëndësi praktike për kryerësin, sepse për veprimet përgaditore kryerësi zakonisht nuk ndëshkohet, kurse për tentativën dënohet.

b) Kusht u dytë në aspektin e së drejtës penale tentativa konsiderohet se është kryer vetëm kur veprimet e drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale të jenë kryer me dashje.

Pra kërkohet që kryerësi të jetë i vendosur për të kryer veprën, si dhe i vetëdijshëm për të gjitha tiparet e veprës penale konkrete.

Ekzistenca e dashjes tek tentativa presupozon që, personi parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre duke u përpjekur kështu për të kryer veprën penale konkrete, të ndërmarrë veprimet të drejtpërdrejta për të realizuar atë çfarë ai kishte parashikuar. Nuk do të konsiderohet se ekziston tentativa nëse kryerësi nuk ka vendosur të kryejë veprën e caktuar, edhe pse i ka ndërmarrë disa veprime, p.sh. kur kryerësi nxjerr nga këllëfi thiken dhe i drejtohet tjetrit, por akoma nuk ka vendosur të godasë mbi të. Për tu konsideruar veprimi si pjesë përbërëse e veprës penale dueht që ky veprim të jetë drejtuar drejt realizimit të saj dhe duhet që dhe nga ana subjektive veprimi të jetë bërë po për këtë qëllim për këto arsye me të drejtë është pranuar se në teorinë e së drejtës sonë penale tentativa si fazë paraprake e kryerjes së veprës penale, kryeht gjithmonë me dashje direkte.

Lind pyetja, se a mund të kemi tentativë të kryer me dashje eventuale indirekte?

Lidhur me të ka pasur mendime të ndryshme.

Disa autor pranojnë mundësinë e kryerjes së tentativës me dashje eventuale, por thonë se në praktikë është e vështirë të vërtetohet se personi ka tentuar me dashje eventuale të arrijë një rezultat të caktuar, shoqërisht të rrezikshëm. Sipas mendimit të tyre tentativa mund të kryhet si me dashje direkte ashtu edhe me dashje indirekte.¹³ Ja një shembull ku disa autor sqarojnë qartë atë që thojnë se tentativa mund të kryhet edhe me dashje indirekte, në ato raste kur subjekti qëllon me armë zjari kundër personit që ai dëshiron ta vrasë, kur ky ndodhet shumë afër me një shokë të tij. Në këtë linjë kur subjekti qëllon kundër armikut të tij, ai vepron me dashje direkte, por në të njëjtën kohë ai parashikon se plumbi mund të përek dhe personin tjetër, i cili ndodhet

¹³Shefqet Muçi, Edrejta penale pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2007, fq.180

përan tij. Megjithëse vrasjen e këtij personi, subjekti nuk e dëshiron, këta autor shprehen se subjekti duke qëlluar kundër armikut të tij, lejon me ndërgjegje edhe vrasjen e personit tjetër. Në qoftë se personi tjetër nuk vritet, në të tilla raste ndodhemi përpara tentativës së vrasjes me dashje indirekte. Autoret e tjerë, mendimet e të cileve përputhen më qëndrimet e të drejtës sonë penale, shprehen se tentativa nuk mund të kryhet me dashje indirekte.

Është praktikisht e pamundur të vërtetohet se personi i cili ka vrarë ose ka tentuar të vrasë armikun e tij, që ndodhet pranë një personi tjetër, ka tentuar me dashje indirekte të vrasë edhe këtë person, por dhe për faktin se ajo nuk pajtohet dhe më përcaktimin e vetë tentativës. Në tentativë, veprimi mund të drejtohet drjtëpërsëdrejti në realizimin e veprës penale vetëm atëherë kur personi ka parashikuar se me anë e tij do të arrihet një rezultat i caktuar shoqërisht i rrezikshëm, rezultatin të cilin personi e ka dëshiruar.

c) Kushtë i tretë i cili duhet për tu konsideruar se egziston tetntativa është ajo që të mos shkaktohet pasoja e veprës penale të cilën personi ka dashur ta shkaktoj me veprimin e ndermarrë.

Veprat mos përfundohet, përkatësisht që të mos shkaktohet pasoja e vepës penale të cilën personi ka dashur të shkaktoj me veprimin e drejtpërdrejtë që ai ka ndërmarrë, për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij. Pra kërkohet mosshkaktimi i pasojës së veprës penale sepse në të kundërtën nuk do të bëhej më fjalë për fillim të veprës penale, përkatësisht tentativës, por për vepër penale të përfunduar të kryer. Kërkohet që vepra penale të mos jetë kryer për shkaqe të pavarura nga vullneti i personit, sepse në të kundërtën nuk do ishim përpara tentativës, por para heqjes dorë nga kryerja e veprës penale.¹⁴ Vepra në rastin e tentativës nuk përfundohet për shkak të veprimit të faktorëve të jashtëm, të palidhur me dëshirën e personit që ndërmerrë veprime të drejtpërdrejta për të kryer veprën penale, të tillë faktorë mund të jenë veprimet e personit kundër të cilit po tenton subjekti që të kryjë veprën, veprimet e personave të tretë të cilet pengojnë subjektin që të kryjë veprën që ai kishte dashur të realizonte, fenomen natyror, si dhe çdo veprim tjetër i jashtëm. Nëse përmbushen këto tre kushte atëherë në të drejtën penale konsiderohet se është kryer tentativa e veprës penale.

Në praktikë ka raste ku vepra penale e dëshiruar nuk përfundohet, por veprimet e personit i cili i ka ndërmarrë kanë shkaktuar pasojat e një vepre penale.

¹⁴ Ismet Salihu, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtin 2003, fq.345

Atërher, në këtë rast për tu konsideruar se cila vepër penale është kryer si bazë merret elementi subjektiv, dashja e atij personi, se cilën vepër ka dashur që ta krye, p.sh personi

X shkrep me armëndrejtim tëpersonit Y, me qëllim qëta privoj nga jeta dhe e godet nëkërah, ku i shkakton lëndim tërëndëtrupor. Njëkëtërast edhe pse janëpërmbushur tëgjitha elementet e veprës penale lëndim i rëndëtrupor tëshkaktuar me armëzjarri, këtu kemi tëbëjm me veprën penale vrasje nëtenativ, sepse qëllimi apo dashja e personit X ka qenëqëpersonin Y ta privoj nga jeta.

Megjithatë duhet patur kujdes në përcaktimin e tentativës. Kjo për shkak se, vet figura e tentativës paraqet të gjitha elementet e veprës penale prefekte edhe pse rezultati final i dëshiruar nuk realizohet, prapë elementet përbërse të sajë si fakti tipik, fajësia dhe kryerja e një sjellje ligjërish të ndaluar, realizohet, në tërësin unitare të parashikuar nga noramt ligjore.

Kodi Penal i Maqedonisë për përcaktimin e vendit se ku është kryer tentativa e veprës penale, ka përvetësuar teorinë e Ubikivitetit. Tentimi i veprës penale llogaritet si i kryer si në vendin ku ka punuar kryersi, ashtu edhe në vendin ku siaps paramendimit të tij është dashur të shkaktohet ose ka mundur të shkaktohet pasoja.¹⁵

1.3.1 Qëllimi i Tentativës së Veprës Penale

Vendosja e qëllimit për tëkryerëvepër penale ështëçelsi i kryesor për atëvepër.

Në një tentativë të veprës penale ndodhemi në rastet kur kryerësi i vepres ka një qëllim për të kryer një veprë penale dhe merr hapat e konsiderueshëm drejtë përfundimit të veprës, edhe pse merr të gjitha hapat për ta përfunduar veprën, por përsëri ajo nuk shkon deri në arritjen e qëllimit final.

Elementi e qëllimit kriminal që kërkohet për tentativën e veprës penale në shumicën e juridiksioneve është qëllimi specifik për të kryer veprën. Jo të gjitha veprat penale që kryerësi ka për qëllim ti kryej tentohen, ligjërish vetëm ato tentativa me qëllime specifike. Qëllimi specifik i referohet gjendjes së mendjes në të cilën një individ planifikon që të kryej një vepër penale, duke e ditur se çfarë mund të jetë rezultati. Çdo herë kur flitet për tentativën e veprës penale na bjenë ndërmend qëllimi, mendojmë qëllimin që kryerësi e dëshiron. Ke tentativa e vrasjes qëllimi i

¹⁵ Kodi penal i RM-së, Shkup, 2015 neni 3, paragrafi 2.

kryerësit është që ta privoj nga jeta viktimën ke tentativa e përdhunimit qëllimi i kryerësit është të kryej marrdhënje seksual kundërejtet dëshirës së partnerit.

Në praktik paraqiten edhe rastet e tentativës së pa qëllimtë, rasti i tentativës së pa qëllimtë është p.sh një personi X shkon në piknik në pyell, dhe ndez një cigare, pasi pin cigaren e hedh në barin e that, dhe fillon te ndizet, edhe pse është krijuar figurë e tentativës së veprës penale, por personi X nuk konsiderohet fajtor pasi që ka munguar elementi subjektiv qëllimi, personi në këtë rasta nuk ka pasur asnjë qëllim specifik por vetëm se ka vepruar nga pakujdesia.

Qëllimi i tentativës është shumë me rëndësi për të drejtën penale, pasi që duke hulumtuar dëshirën dhe qëllimin që kryerësi don të arrijë me anën e asaj vepre edhe më lehet caktohet masa e ndëshkueshmëris, se në varësi të qëllimit ndryshon masa ndëshkuese.¹⁶

Metoda tradicionale që analizon përkufizimine e një vepre penale, bëhet me anë të actus reus (që përshkruan veprimet e të pandehurit), dhe mens rea (që përshkruan specifikat e të pandehurit).¹⁷

Actu reus është element që përshkruan se në çfar rrethanash dhe me çfar pasoja ka ngel vepra në tentativë.

Mens rea (mendja fajtoare) është elementi kryesor për të kryer një vepër penale.¹⁸ Koncepti Mens rea u zhvillua në Angli, kur gjyqëtarët filluan të thonin se një veprim i vetëm nuk mundë të krijonte përgjegjësi penale përveç nëse shoqërohet me mendjen fajtoare. Mens rea herë pasë here mund ta përdorim si sinonim të fjalës qëllim i përgjithshëm¹⁹

Asnjë tentativë për të kryer vepër penale nuk muret pa pasur qëllim dhe pa synura aritjen e këtyre qëllimeve specifike, por gjithëmon këta qëllime duhet të jen me dashje.

1.3.2 Ndëshkimi i tentativës së veprës penale sipas Kodit Penal të Maqedonisë dhe aplikueshmëria e dënimit nga ana e gjykatës

Përgjegjësia penal përcaktohet nëçdo rast duke u bazuar nëparime dhe pozita tëpërcaktuar nëKodin Penal. E drejta jonëpenale përmbanparimin e përgjegjësise penale si nëfigurën e veprës penale tëmbetur nëfazëne tentativës, ashtu edhe për atëtëveprës penale tëkonsumuar plotësisht.

¹⁶Shefqet Muçi, Edrejta penale pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2007, fq. 175

¹⁷ Jonathan Herring, E Drejta Penale, Tiranë, 2013, fq 70

¹⁸Michael Allen, Criminal Law, 2003, fq 49

¹⁹ po aty

Tentativa e veprës penale sipas Kodit penal të RM-së ndëshkohet kur autori tenton të kryej veprën penale për të cilën siaps ligjit mund të shqiptohet burgim prej pesë vitësh ose dënim më të rëndë.²⁰

Për kundër faktit se Kodi Penal i Maqedonisë, dënon tentativën e atyre veprave penale për të cilat mund të shqiptohet dënim me burgim sëpaku pesë vjetë, por në disa raste Kodi Penal parasheh mundësinë e ndëshkimit të tentativës edhe për veprat penale për të cilat është paraparë dënim më i lehtë se pesë vjetë, nëse kjo mundësi parashihet me ligj.

Rastet e tilla të ndëshkimit të tentativës së veprës penale për të cilat është paraparë dënim më i lehtë se pesë vjetë burgim janë:

Shpërngulja e paligjshme (neni 246) për këtë veprën penale është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në një vjetë, mirpo edhe tentimi është i ndëshkueshëm.

Dëmtimi dhe hyrja e paautorizuar në sistemin kompjuterik (neni 251-a) tentimi për veprën nga paragrafi 1 dhe 2 është i ndëshkueshëm. Mashtrimi kompjuterik (neni 251-b) tentimi për veprën nga paragrafi 1 dhe 4 është i ndëshkueshëm. Marrja e automjetit (neni 242) tentimi për veprën nga paragrafi 1 është i ndëshkueshëm. Kontrabanda (neni 278) tentimi për veprën nga paragrafi 1 është i ndëshkueshëm. Mashtrimi doganor (neni 278-a) dhe fsheja e mallrave që janë lëndë kontrabandë dhe mashtrimi doganor (neni 278-b) tentimi për veprën nga paragrafi 1 është i ndëshkueshëm. Dhuna ndaj personave ushtarak gjatë kryerjes së detyrës zyrtare (neni 332) tentimi për veprën nga paragrafi 1 është i ndëshkueshëm. Dhuna ndaj puntorit gjygjësor (neni 375) tentimi është i ndëshkueshëm.

Heqja ose dëmtimi i vulës apo i shenjës zyrtare (neni 389). Marrja ose shkatrimi i vulës apo shkresës.

Sipas nenit 19 paragrafi 2, kryerësi do të ndëshkohet për tentim në kufijtë e dënimit të caktuar për veprën penale, por mund të ndëshkohet edhe me butë.

Gjykata në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, si dhe shkaqeve për të cilat krimi mbetet në tentativë, dënimin dhe mund ta ulatë në minimumin e parashikuar me ligj. Paragrafi 2 i këtij neni i referohet aspektit ndëshkimor që gjykata duhet ta vlerësojë në rastet konkrete për të dhënë një dënim të përshtatshëm me rrethanat në të cilën ka ndodhur tentativa.

Kuptohet që shkalla e dënimit të veprës penale të lënë në tentativë nuk mund të jetë kurrë njëjtë me shkallën e dënimit të caktuar nga neni i posaçëm që e dëclon veprën, pasi figura e

²⁰ Kodi Penal i RM-së, 2015 neni 19

tentativës ka veçoritëe saj, duke filluar nga shkalla e rrezikshmërisë efektive qëajo paraqet për tëmirën juridike tëmbrojtur, nëkrahësimin efektiv tëveprës penale dhe dëmin e shkatuar qërealizohet me sjelljen deri nëfund tëveprimit tëdështuar.

Pra nga kjo analizë sintetike mund tëthemë qëgjykata nëdhënjën e dënimit për rastetë e tentativës duhet tëketëparasyshë, shkallën e afërsisë sëpasojës, kjo merrnjëvlerë tëveçantë nëpërcaktimin e dënimit tek tentativa, pasi ai ndikon nëhetimin direkt tëshkallës së rrezikshmërisë qëkryhet në dëmtësëmirës juridike tëmbrojtur. Sa mëe madhe është distanca mes veprimit e pasojës tëveprës penale, aq mëe madhe është mundësia e forcave ndërhyrëse, të cilat mund tëevitojnë pasojat e veprës penale dhe nëtëkundërtën, sa mëe vogël kjo distancë, aq mëshumëmbillet rrethi i kushteve favorizuese tërezultatit, dhe aq mëe vogël mundësia e ndërhyrjes sëndonjë force qëmund tëevitojë veprën.

Gjykata merr parasysh edhe shkaqet të cilat krimi mbetet nëtentativë. Nëkonfigurimin e këtij elementi mund tëthemëiqë shkaqet të cilat nuk lejuan kryerjen e veprës penale mund tëjenësi objektive ashtu edhe subjektive.

Qëllimi i politikave kriminale për tëparashikuar dhe ndëshkuar tentativën lind nga domosdoshmëria për tëparandaluar ekspozimin e tëmirës, juridikisht tëmbrojtur ndaj një rreziku.

1.4 Aspektet komperative tëtentativës sëveprës penale

Ky problem është trajtuar nëmënyra tëndryshme dhe si rrjedhim nuk ka pasur unitet pikpamjesh. Njëgrup autorësh mbrojnë pikpamjen e mohimit tëekzistencës sëelementeve tëfigurës sëveprës penale, tëmbetur nëfazën e tentativës, duke pranuar se figura e veprës penale egziston vetëm atëherëkur ajo është kryer plotësisht, kurse përgjëgjësia penale për vepërat e mbetura nëfazën e tentativës është njëpërjashtim nga rregulli i përgjithshëm. Përa sipas mendimit tëtyre, për vepërat penale tëmbetura nëfazën e tentativës nuk egziston figura e veprës penale, kjo egziston vetëm nëveprat penale tëkryera plotësisht. Njëpikpamje tjetër, e mbështetur nga njëgrup i gjërëpenalistësh qëpranojnëqë nënien e figurës sëveprës penale si nëato raste kur vepra ka ngelur nëfazën e tentativës gjithëashtu dhe kur ajo është kryer plotësisht.

Definicionin e tentativës sëveprës penale tëgjitha kodetë penale e definojnënjëjtë, por kurbëhet fjalëpër dënushmërin e saj me ligj, ka dallime ndërmjet Kodeve penale tështeteve tëndryshme dhe kodit tonëpenal.

Kodi ynë Penal kryerësin e veprës penale të ngulur në tentativë e definon kështu: Ai i cili me paramendim do ta fillojë kryerjen e veprës penale, por nuk do ta përfundojë do të dënohet për tentim të veprës penale për të cilin sipas ligjit mund të shqiptohet burgim prej pesë vjetësh ose dënim më të rëndë.²¹ Ndërsa Kodi Penal i Kosovës Tentativën e definon kështu: kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë veprën penale. Tentativa për të kryer veprën penale për të cilën mund të shqiptohet dënim me tre ose më shumë vite burgim dënohet.²²

Dallimi ndërmjet Kodit Penal të Kosovës dhe kodit Penal të Maqedonisë është në dënimin e veprës penale. Kodi Penal i Maqedonisë ndëshkon kryerësit për veprat penale për të cilat parashihet burgim pesë vite, ndërsa Kodi Penal i Kosovës ndëshkon kryerësit për tentativën e veprës ku me kodin Penal është paraparë dënim me burgim tre vite.

1.4.1 Tentativa e veprës penale sipas kodit Penal të Kosovës

Tentativa si përkufizim është dhënë në nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës. Sipas tij kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtëpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë veprën penale.²³

Sipas Kodit Penal të Kosovës tentativa do të egzistojë në rastet kur vepra penale ka filluar të kryhet, mirëpo nuk është shkaktuar pasoja e dëshiruar.

Në aspektin juridiko Penal, për tu konsideruar se është kryer tentativa e veprës penale, duhet që të përmbushen tri kushte²⁴

- a) Që të ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale
- b) Që veprimi të ndërmerret me dashje
- c) Vepra të mos përfundojë.

²¹ Kodi Penal i RM-së, 2015, neni 19

²² Kodi Penal i Kosovës, 2016, neni 28

²³ Salihi Ismet, Edrejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2012, fq 342

²⁴ Po aty

Nëse përmbushen këto tri kushte, atëherë në të drejtën penale konsiderohet se është kryer tentativa e veprës penale. Mirëpo, meqëme tentativën nuk shkaktohet pasoja e veprës penale, në teorinë e së drejtës penale lindin dilema se cilët shakqe e arsyetojnë ndëshkimin për tentativë. Lidhur me këtë çështje, në shkencën e së drejtës penale janë parashtruar tri teori:

1. teoria objektive

2. teoria subjektive

3. teoria objektive - subjektive²⁵

Sipas teoris objektive, tentativa paraqet rrezikimin e të mirës juridike që është mbrojtur me të drejtën penale. Kjo në fakt paraqet sulm në të mirën juridike. Për këtë arsye tentativa konsiderohet veprë e rrezikshme shoqërore.

Sipas teoris subjektive, tentativa mbështetet në vullnetin e personit që të kryjë veprën penale, vullneti i cili është manifestuar në botën e jashtme. Sipas kësaj teorie personi duhet të dënohet për tentativën e veprës penale ngase e ka manifestuar vullnetin e tij kriminal.

Teoria objektive subjektive është bashkim i dy teorive. Sipas kësaj teorie kryerësi i tentativës dënohet për shkak se ka rrezikuar të mirën juridike dhe për shkak se me atë rast e ka manifestuar vullnetin e tij kriminal për të kryer veprën penale.

1.4.2 Ndëshkimi i tentativës sipas kodit penal të Kosovës

Duke marrë parasysh natyrën dhe peshën e veprës penale si dhe duke përvetësuar teorinë objektive-subjektive, e drejta penale e Kosovës e zgjedh çështjen e ndëshkimit për rastet e tentativës. Rrjedhimisht sipas paragrafit 2 neni 28 të Kodit Penal, për tentativë personi dënohet kur është fjala për veprat penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi me burgim më së paku tre vjet, ndërsa për tentativën e veprave të tjera penale më të lehta, vetëm atëherë kur me ligj shprehimisht parashihet se edhe për tentativë dënohet.²⁶ Rasti i tillë i ndëshkimit të tentativës së veprës penale për të cilat është parapar dënimi më i lehtë se tre vjetëshe, për shembull tentativa e veprës penale

²⁵ PO aty

²⁶ Ismet Salihu, H. Zhitija, F. Hasani, Komentari i kodit penal të Kosovës, Prishtinë,

tëmarrjes sëpasurisë sëluajtshme,për tëcilën ështëëparaparë dënim me gjobëapo me burgim deri nëgjashtëmuaj.²⁷

Pra, këtu pesha e veprës penale apo intenziteti i rrezikshmërisë ështëëpërcaktuar me llojin dhe masën e dënimit tëparaparë.

Nga kjo dispozitëe Kodit Penal tëKosovës rezulton se nëtëdrejtën penale të Kosovës nuk ndëshkohet tentativa tek tëgjitha veprat penale. Për tentativëpersoni do tëdenohet vetëm kur ështëfjala për vepra penale mëtërënda.

Kodi penal i Kosovës, në nenin 28 paragrafi 3, ka paraparëqëpersoni i cili tenton tëkryejvëpër penale, pra kur vepra penale mbetet nëtentativë, dënohet mëbutësesa personi i cili e ka përfunduar (kryer veperën penale)

Kjo zbutje e dënimit bëhet në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të Kodit Penal tëKosovës, qëthotëse dënimi i shqiptuar për tentativënuke duhet tëjetëmëi lartëse tre e katërta e maksimumit tëdënimit tëparaparëpër vepër penale.²⁸

1.5 TENTATIVA E VEPRËS PENALE SIAPS KODIT PENAL TË SHQIPËRISË

Kodi Penal Shqiptarëaktual i miratuar dhe hyrënëfuqi nëvitin 1995, i bën njërrëgullim tëplotëtentativës, si njënga fazat e veprimtarisëparaprake kriminale tëkryerjes sëveprës penale, e pikërisht nënenin 22 tëpjesës sëpërgjithshme.

Kështu neni 22 parashikon: Vepra penale quhet e mbetur nëtentativëkur megjithëse personi ndërmer veprime tëdrejtëpëdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana tëpavarura nga vullneti i tij.²⁹

Pra, tentativa konsiston veprime tëdrejtëpëdrejta tëpersonit për kryerjen e veprës penale por qëkto veprime ndërpritet dhe kjo e bën qëvepra penale e nisur tëmos përfundohet e tëmos sjellkështu pasojën e dëshiruar dhe tëparashikuar për tëardhur, si rezultat i kryerjes sëveprimeve tëpërgaditura më parëprej tij.

Tentativa ështënjënga fazat paraprake tëkryerjes sëveprave penale me dashje, sepse personi pasi ka përgaditur kushtet dhe mjetet, me qëllimin kryesor për tëkryer njëvëpër penale, ndërmer

²⁷ Kodi Penal i Kosovës, 2016, neni 331

²⁸ Kodi Penal i Kosovës, 2016, neni 65

²⁹ Kodi Penal i Shqipërisë, Tiranë, 2011

veprime të drejtëpërdrejta për ta kryer veprën penale, por që për rrethana të pavarura nga vullneti i tij, kryerja e plotë e veprës penale nuk realizohet e kështu vepra penale cilësohet e mbetet nëntentativë.

Pavarësisht se vepra penale ka mbetur në fazën e tentativës e drejta penale e Shqipërisë parashikon vënien para përgjegjësisë penale, personin i cili konsiderohet se ka kryer një veprë penale të mbetur nëntentativë.

1.5.1 Ndëshkimi i tentativës së veprës penale sipas Kodit Penal të Shqipërisë

E drejta penale e Shqipërisë qëndron plotësisht në pozitën e pranimi të përgjegjësisë penale, si për figurën e veprës penale të mbetur në fazën e tentativës, ashtu edhe për atë të veprës penale të konsumuar plotësisht. Kur figura e veprës penale, ka mbetur në fazën e tentativës, ajo do të cilsohet sipas dispozitave përkatëse të pjesës së posaçme në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Shqipërisë, e drejta penale e Shqipërisë duke pranuar përgjegjësinë penale lidhur me veprën penale të mbetur në fazën e tentativës, nuk bën gjë tjetër vetëm se i përgjigjet në mënyrë të plotë dhe me efektivitet të lartë luftës kundër kriminalitetit. Kështu momenti i fillimit të veprimtarisë së tentativës kriminale e deri në arritjen e rezultatit përbëjnë një unitet të pandarë kriminal.

KAPITULLI I DYTË

2.1 LLOJET E TENTATIVAVËS SËVEPRËS PENALE

Meqenëse tentativa konsiderohet e kryer si nërastin ku veprimi i kryerjes ka përfunduar, ashtu dhe nërastin kur ky veprim vetëm ka fillur (por gjithëmonëme kusht qëpasoja e veprës penale tëmos jetëshaktuar), nëtëdrejtën penale njihen disa ndarje nëlloje tëtentativës, ndarje qëe drejta jonëpenale i bëtentativës ka rëndësi sepse gjykata nëcaktimin e dënimit duke marrëparasyshëshkallën e rrezikshmërisë, afërsin e ardhjes sëpasojave si dhe shkaqeve për tëcilat nuk u përfundua vepra, ajo mund tëuldënimin nën minimumin e parashikuar nga dispozita ligjore ose mund tëcaktojënjëdënim mëtëbutënga ajo çka ka parashikuar ligji.

Nëdhënjën sa mëtëplotëtëpërkufizimit tëtentativës, doktrina jonëështëmunduar tëpërcaktoj disa lloje tentativash, duke i përshtatur ato nëvarësi tëtipologjisësëmjetëve qëpërdoren për tëvënënjëjetëprojektin kriminal.

Kështu doktrina ka elaboruar disa lloje tentativash si:

Tenativa e plotëapo e kryer (delictum prefectum), tentativa e metëapo e pakryer (delictum inprefectum), tentativa e papërshtatshme dhe tentativa e cilësuar apo e kualifikuar.³⁰

2.1.1 Tentativa e plotë

Do të kemi tentativëtëplotëatëherëkur personi ka filluar dhe përfunduar veprimet por pasoja e parashikuar dhe e dëshiruar prej tij nuk ka ardhur për shkaqe tëpavarura prej tij.

Pra autori ka kryer tëgjitha veprimet, qësipas tij ishin tëdomosdoshme për realizimin e veprës penale, veprime tëcialt ishin drejtuar drejtëpërdrejtëpër kryerjen e veprës dhe ardejn e pasojve shoqërisht tërrezikshem, por qëshkaqe tëpavarura nga vullneti i tij këto pasoja nuk kanëardhur. P.sh. një person hynënjëbanesë merr gjësende nëkasafortë, por kapet nëvendin e kryerjes sëkrimit dhe vepra mbetet nëtentativë.

³⁰ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq.

Njëtetër rast mund tëpërmendim për shembull njëperson godet me njësend tëfortë njëperson tjetër me qëllim qëta mbytë, por qënuk veptoi mëtej për shkaqe tëpavarura nga vullneti i tij, kështu qëvepra do tëpranohej e mbetur nëfazën e tentativës.

Nëtentativën e plotëpersoni kryen tëgjitha veprimet për tësjellërezultatit e dëshiruar, ndonëse ato nuk paraqiten për shkaqe tëpavarura nga vullneti i tij.

2.1.2 Tentativa e metë

Tentativa e metë, konsiderohet se egzistonatëherë kur personie fillon veprimin e kryerjes por nuk e përfundon, nuk kryhen tëgjitha veprimet e parashikuara për kryerjen e veprës penale te parashikuar.³¹

Për shembull autori i veprës penale tëvrasjës ndonëse ka drejtuar armën kundër personit qëka vendosur tëvrasë, ka vënëgishtin nëkëmbëzën e pushkës, por nuk e shkrep atëse nëmoment del njëperson tjetër përpara viktimës dhe për tëmos u rrezikuar ai, subjekti tërhiqet dhe vendos ta kryejëvrasjen nënjëkohëtjetër e nënjëvend mëtvolitshëm.

Pra personi nuk mundtëpërfundoj tëgjitha veprimet e nevojshme dhe tëdomosdoshme për kryerjen e plotëtëvepres penale dhe ardhjen kështu tëpasojave tëparashikuara dhe tëdëshiruara.

Nëdallim nga tentativa e plotëku autori kryen tëgjitha veprimet e nevojshme dhe tëdomosdoshme për tëkryer veprën, por qëpër shkaqe tëpavarura nga ai këto pasoja nuk vijnë, nëtentativën e metë, autori nuk kryen tëgjitha ato veprime qëishin tëdomosdoshme për tëkryer veprën penale.

Dallimi midis tentatives sëplotëdhe tëmetëështëi rëndësishëm lidhur me çështjen e heqjes dorëvullnetare nga kryerja e veprës penale dhe matjes sëdënimit. Rrjedhimishtpër tentativën e metënëpraktikën gjyqësore shqiptohet dënimi mëi butënëkrahësim me tentativën e plotë

³¹ Salihu Ismet, E Drjeta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2003, fs 347

2.1.3 Tentativa e papërshtatshme

Sipas nenit 20 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, tentativë të papërshtatshme do të kemi atëher kur kryerësi do të tentojë të kryejë vepër penale me mjete të papërshtatshme ose ndaj sendit të papërshtatshëm.³² Definimi ligjorë i tentativës së papërshtatshme përmban këto elemente: paramendimi për kryerjen e veprës penale, fillimi me kryerjen e veprës penale dhe papërshtatshmëria e mjetit me të cilin kryeht ose sendi kundër të cilit kryhet vepra penale.³³

Tentativa e papërshtatshme është formë speciale e veprës së pakryer, për të cilën është karakteristikë paramendimi i kryerësit për kryerjen të veprës dhe pamundësia objektive për kryerjen e saj. Në këtë rast kryerësi ka ide të gabuara se mund të kryjë veprën me mjete të tilla ose kundër sendit të tillë. I papërshtatshëm është ai tentim kur kryersi dëshiron të privoj nga jeta një person, mirpo nuk arin ta vëret nga shkaku se armës i është prishur gjilpëra.

Si kriter themelor për tu konsideruar një tentativë e papërshtatshme është vlersimi se me mjetet që janë pëdorur ndaj objektit përkatës, në situatën dhe rrethanat konkrete, askush nuk do të mund të kryente veprën penale. Përkundrazi nuk do të konsiderohet se egziston tentativa e papërshtatshme nëse mjetet të cilat janë përdorur kanë mundur të shkaktojnë pasojën e veprës penale, mirëpo kryerësi nuk ka ditur ti përdor ato.

Tentativa e papërshtatshme mundë të paraqitet edhe te vepra penale putative (e imagjinua).³⁴ Është e mundur kryerësi gabimisht të mendojë se fillon të kryejë vepër penale e cila sipas Kodit Penal të RM-së aspak nuk është e parapar si vepër penale. Në shkencën e së drejtës penale, si dhe në disa legjislacione penale, njihen dy lloje të tentativës së papërshtatshme: tentativa e papërshtatshme absolute dhe tentativa e papërshtatshme relative.³⁵

³² Kodi penal i RM-së, Shkup 2015

³³ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, Tetovë 2018, fq.177

³⁴ Kambovski Vllado, E drejta penale, Shkup 2007, fq 336

³⁵ Salihu Ismet, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, fq 350

2.1.3.1 Tentativa me mjete të papërshtatshme

Këtu bëjnë pjesë të gjitha ato mjete të cilat nuk janë në gjëndje të shkaktojnë efektin e dëshiruar nga subjekti aktiv. Ato përdoren nga agjenti veprues me qëllim prodhimin e pasojës së dëshiruar, por kjo nuk arrihet sepse mjete i përdorur nuk është në gjëndje të sigurojë manifestimin e qëllimit final.

Veprime të cilësuar si tentativa me mjete të papërshtatshme do të kemi kur p.sh një person hyn në zyrat e një ndërmarje për të vjedhur paratë që ndodhen në kasafortë, mirëpo si mjete të vjedhjes ai kishte vetëm një sharrë me defekte dhe nuk kishte gjetur çelsat e përshtatshme për hapjen e kasafortës dhe si pasojë vepra mbetei në fazën e tentativës.

Gjithësesi, subjekti veprues në përfaqësimin që ai i bën situatës dhe pasojave, është i bindur që mjete që vë në përdorim për realizimin e veprës penale, është në gjëndje të sjellë pasojën, panvarsisht se ajo nuk realizohet.

Pra, subjekti i ka përdorur këto mjete, por që për shkak të cilësive të tyre janë të papërshtatshme për të arritur rezultatin e dëshiruar.

Tentativë të papërshtatshme lidhur me mjetin me të cilin tentohet të kryet vepra penale konsiderohet se egziston edhe në rastin kur meji është i përshtatshëm, por në rrethanat në të cilat është tentuar të kryhet ajo vepër nuk ka mundur të shkaktojë pasojën e ndalur, sepse për ato rrethana ai mjet është e papërshtatshme. Një shembull nga kjo që shpjeguar është, kurë personi me pushkën e cila është plotësisht në rregull, është plotësisht funksionale, shkrep me të prej një distance të largët nga e cila kurrsesi nuk ka mundu ta godas personin të cilin ka dashur që ta privoj nga liria.

Në këto raste gjatë shqiptimit të dënimit gjykata e Maqedonisë konsideron se është kryer tentativa e papërshtatshme e vrasjes.

Si kriter themelor për tu konsideruar një tentativa me mjete të papërshtatshme është se me mjetet që janë përdorur ndaj objektit përkatës, në situata dhe rrethanat konkrete askush nuk do të mund të kryente veprën penale.

2.1.3.2 Tentativa papërshtatshme lidhur me objektin

Tentativa e papërshtatshme lidhur me objektin ekziston kur objekti i veprës penale fare nuk ekziston, apo kur objekti nuk i ka ato tipare që janë të domosdoshme për të mundur të kryhet vepra penale, kur tentativa bëhet kundër një raporti juridik të paprekshëm ose të pashkatrueshëm në rrethant konkrete në të cialt ka vepruar pesoni. Për të ilustruar më qatë profilet problematike që ka ky konfigurim kam dhënë disa shëmbuj, personi shkrep me pushkë në kufomë kurse kryesi mendon se është njeriu i gjallë, abortimin ndaj femrës që nuk është shtatzën, dhënia e mitos personit që nuk është kompetent për të kryer ndonjë punë zyrtare, hedhja e bombës në dhomën në të cilën zakonisht në kohën e caktuar gjendet personi të cilin dëshiron ta privojë nga jeta, mirëpo ky rastësisht ka dalë jashtë, futja e dorës në xhepin e tjetrit mirëpo në të nuk gjenë asgjë.

Janë të mundura edhe rastet kur edhe mjeteti dhe objekti janë të papërshtatshme për kryerjen e veprës penale³⁶. Për shembull, tentativa e veprës penale të dështimit të palejuar me mjete të papërshtatshme ndaj femrës që nuk është shtatzën.

Te të gjitha llojet e tentativave të papërshtatshme, qoftë lidhur me mjetin apo lidhur me objektin apo me të dyja, kryesi nuk është i vetëdijshëm për papërshtatshmërin. Praktikisht, nuk është i vetëdijshëm se nuk do të mund ta kryejë veprën penale. Në të kundërtën, nëse është i vetëdijshëm, e din se mjetet të cilat i përdor ose ndaj objektit ndaj të cilit ndërmerr veprimin e kryerjes nuk mund ta kryej veprën penale.

Papërshtatshmëria lidhur me objektin e papërshtatshëm dhe me mjetet e papërshtatshme gjithëmon duhet të vërtetohet në relacion me situatën në të cilën është tentuar.

2.1.3.3 Tentativa e papërshtatshme absolute dhe relative

Tentativa e papërshtatshme absolute ekziston atëherë kur mjetet me të cilat është tentuar kryerja e veprës penale apo objektin ndaj të cilit është tentuar të kryhet vepra penale, kurrësi në asnjë rastë, nuk mund të kryhet vepra penale.³⁷ Për shembull shkrepja nga pushka e zbrastë, këtë

³⁶ Komentari i Kodit Penal të RM-së, Shkup, 2015

³⁷ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018. fq.178

rastë kemi tentativë të papaërshtashme absolute lidhur me mjetin, por ka raste kur kemi tentativë të papërshtatshme absolute lidhur objektin ndaj të cilit është tentuar të kryhet vepra penale një rastë i tilli është, shkrepja me pushkë në personin i cili pak më parë ka vdekur.³⁸

Tentativa e papërshtatshme relative ekziston atëherë kur mjetet të cilat janë përdorur, apo objekti ndaj të cilit është ndërmarë veprimi për shkak të egzistimit të disa efekteve ato kanë qenë të papërshtatshme për të kryer veprën penale. Të cilatë parimishtë janë të përshtashme, por në rastin konkret janë treguar si të papërshtatshëm. Tentativë të papërshtatshme relative do të kemi për shembull, kur subjekti me qëllim që të kryej vepër penale të vrasjes përdorë helmin me afat të skaduar, apo rasti tjetër, kur subjekti shtie me armë në personin që dëshiron që ta privoj nga jeta, mirëpo plumbi nuk shkrep ngase ka qenë i lagur.³⁹

2.1.4. Natyra juridike e tentativës së papërshtatshme

Në teori shqyrtohet çështja e justifikushmërisë së kufijve të dënimit për tentativë të papërshtatshme të veprës penale. Gjatë përgjigjes për këtë dilemë se a duhet ndëshkuar kryerësi i tentativës së papërshtatshme, egzistojnë tri teori; teoria objektive, teoria subjektive dhe teoria objektive-subjektive.

Sipas teoris objektive dallohen ndëshkimi për tentativë të veprës penale absolutisht të papërshtatshme dhe relativisht të papërshtatshme. Teoria objektive bazën për dënim e kërkojnë në rrezikimin e objektit të paraqitur ndërmejt veprimit të ndëmmarrë. Te tentativa absolutisht e papërshtatshme nuk egziston asnjë mundësi që të paraqiet pasoja e veprës penale që kryerësi e ka dëshiruar, dhe për këtë qëllim nuk duhet të ndëshkohet kryerësi i kësaj tentative. Te tentative relativisht e papërshtatshme, edhe pse tentativa është e papërshtatshme por egziston reziku i dukshëm dhe rreziku këtu është më i madh, ngas në këtë lloj të tentativës së papërshtatshme rreziku është dukshëm më i madh, dhe për këtë qëllim kryerësi i kësaj tentative dënohet.

Sipas teoris subjektive bazë për përgjegjësi dhe dënim është paraqitja e vullnetit kriminal të kryerësit, në të dy llojet e tentativës së papërshtatshme edhe asaj absolute edhe asaj relative,

³⁸ Salihu Ismet, e Drejta Penale pjesa e përgjithshme, Prishtin 2007, fq 350

³⁹ Po aty

përgjegjësi duhet të jepë kryerësi ngase e ka shprehur vullnetin për të kryer vepër penale, panvarësisht se pasoja nuk ka ardhur. Duke marrë për bazë këtë kryerësi duhet të ndëshkohet njëjtë në të dy llojet e tentativave.

Sipas teorisë objektive subjektive për tentativën relativisht të papërshtatshme kryerësi i veprës penale dënohet në parim, për tentativën absolutisht të papërshtatshme kryerësi ndëshkohet

Sipas Kodit penal të Maqedonisë tentativa e papërshtatshme është bazë fakultative për lirimin nga dënimi.⁴⁰

2.2 Tentativa e cilsuar

Në të drejtën penale konsiderohet se ekziston tentativa e cilësuar në rastet kur me veprimin e ndërmarrë është tentuar të kryhet një vepër penale, mirëpo në fakt është kryer figura e një vepre tjetër penale, e cila është përcaktuar me ligjë si vepër penale e posaçme.⁴¹ Rastet e të tilla më së shpeshti ndodhin lidhur me veprat penale të tentativës së vrasjes. Për shembull, personi X shkrep me armë në personin Y me qëllim që ta privoj nga jeta, mirëpo i shkakton vetëm lëndim të rënd trupor. Në këtë rast personi X ka kryer veprën penale të plagosjes së rënd, mirëpo meqë dashja dhe qëllimi i kryerësit ka qenë që të kryejë veprën penale të vrasjes, në të drejtën penale ky person do të konsiderohet se ka kryer veprën penale të tentativës së vrasjes, e jo vepër penale të plagosjes. Pra, në këto raste për kualifikimin e veprës penale është vendimtare dashja e kryerësit, në këtë rast duhet të shihet qëllimi i kryerësit të veprës penale, nëse qëllimi i kryerësit ka qenë që personin ta privoj nga jeta ai edhe pse i ka shkaktoar lëndim të rënd përsëri duhet të dënuar për tentativë vrasje. Fakti që personi me këtë tentativë ka shkaktoar plagosjen do të merret parasysh si rrethanë rënduese me rastin e matjes dhe shqipëtimin të dënimit me çrast gjyqja do ta ketë parasysh edhe dënimin e paraparë për veprën e cila është kryer me tentativë.

Tentativa e cilësuar egziston edhe në ato rastet kur personi heqë dorë nga kryerja e veprës penale, kurr ndalon vazhdimin e mëtejshëm të veprës, p.sh kryerësi tenton të grabit dhe përdor dhunë, por e ndërperet veprën dhe në këtë rast nuk dënohet për grabitje por dënohet për përdorim të dhunës.

⁴⁰Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq. 180

⁴¹Salihu Ismet, e drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2007, fq.348

Tentativa e cilësuar nuk e përfëshin rastin e bashkimit real të veprave penale.⁴²

2.3 Veprat penale në të cilat nuk është e mundur tentativa

Karakteristikë e figurës së tentativës është se tentativa nuk mund të manifestohet te kundërvajtjet penale.

Arsyetimi logjik që përjashton konfigurimin e tentativës tek kundërvajtjet penale lind nga fakti që, për shkak të anës subjektive që e karakterizon, kjo manifestohet vetëm tek ato krime që janë të kryera me dashje.

Në teorinë e së drejtës penale dhe në praktiken gjyqësore konsiderohet se te disa vepra penale nuk është e mundur tentativa. Lidhur me këtë kryesisht njihen dy grupe të veprave penale të cilat nuk është e mundur tentativa.

Në grupin e parë bëjnë pjesë ato vepra penale të cilat në të drejtën penale konsiderohen se janë kryer nëse janë ndërmarrë veprimet përgaditore. Veprat ku është ndërmarrë vetëm veprimi përgaditor dhe konsiderohen se janë kryer vepra penale janë organizimi i grupit për të kryer krime të gjenocidit, krime kundër njerzimit, krime të luftës, trafikimi me njerëz etj.

Në grupin e dytë të veprave penale të cilat nuk është e mundur tentativa, bëjnë pjesë ato vepra penale të cilat për shkak të natyrës së tyre, nuk është e mundur tentativa. Në teori njihen edhe si vepra penale formale, tek të cilat përshkak të natyrës së ktyre veprimeve nuk është e mundur tentativa. Për shembull, veprat e rrezikimit (neni 132) i Kodit penal të RM-së, pjesëmarrja në rraje (neni 135) i Kodit penal të RM-së Braktisja e personit të pa aftë.⁴³

Në grupin e vepra penale që nuk është e mundur tentativa hynë edhe Veprat penale Kundër Nderit dhe Autoritetit pikrisht (neni 173) i Kodit Penal të RM-së Fyerja.⁴⁴ Gjithashtu në këtë grup hynë edhe vepra penale të komunikacionit të cilat shkaktohen nga pakujdesia.

Tentativa gjithashtu nuk mund të konfigurohet në veprat penale të njëtrajtshme apo uniforme. Kjo pasi, tipologjia e veprimeve penale në fjalë, nuk lejon ndarjen e ekzekutueshmëris së qëllimit kriminal në më shumë pjesë. Në këtë tipologji krimesh aksioni kriminal është një dhe kryhet në një veprim të vetëm.

⁴² Kambovski Vllado, E Drejta Penale, Shkup 2010, fq 345

⁴³ Zejneli Ismail, E drejta Penale pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq. 29

⁴⁴ Po aty,

Per shkak të natyrës specifike nuk është e mundur tentativa edhe te veprat penale të drejta të kryera me mosveprim, ngase momenti kur ato konsiderohen se kryehn dhe momenti kur ato hynë në zonën kriminale (kur ndëshkohen) është i njejtë, siç është rasti i veprës penale të mosdhënies së ndihmës mjeksore. Ndërsa në veprat penale jo të drejta të kryera me mosveprim, tentativa është e mundur. Rast i tillë është kur nëna me qëllim që ta privoj nga jeta fëmijën e vetë nuk i jepë ushqimë.

KAPITULLI I TRETË

3. DALLIMI I TENTATIVËS NGA FAZAT TJERA TË VEPRËS PENALE

Kam cekur në fillim të punimit se fazat (stadet) e kryejës së veprës penale janë: vendimi për të kryer vepër penale, veprimet përgaditore, filimi i kryerjes së veprës penale, që mund të ngel edhe në tentativë dhe faza e fundit kryerja e veprës penale, vepra penale e përfunduar.

Secila nga këto katër fazat kryen punën e vetë në rrugën për të aritur rezultatin e dëshiruar të autorit për relizimin e pasojave shoqërore të rrezikshme, të dëshiruara dhe të parashikuara prej tij.

3.1 Dallimi i tentativës së veprës penale nga përgaditja

Përgaditja dhe tentativa janë faza që konsistojnë në kryerjen e atyre veprimeve, që kryerësi të mund të realizoj veprën penale të plotë.

Tentativa dhe përgaditja janë dy faza të ndryshme, dallimi ndërmejt të cileve duhet parë në anën objektive.

Që kryerësi të arrijë pasojat e dëshiruara dhe të parashikuara prej tij ai duhet të kalojë veprimet e tij në disa faza, ku përgaditja është edhe faza e parë e më pas kryerësi tenton të kryejë veprën penale.

Dallimi midis tentativës së veprës penale dhe veprimeve përgaditore, është se në rastin e tentativës, fillohet kryerja e veprës penale të dëshiruar, këtu subjekti ka ndërmarë hapin për të kryer veprën penale, kurse me veprimin përgaditor krijohen vetëm kushtet e përshtatshme për kryerjen efikase të veprës penale, ndërmeret veprimi i kryerjes.⁴⁵

Si veprime përgaditore konsiderohen: studimi i vendit dhe ambientit ku do të kryet vepra, furnizimi ose aftësimi i mjeteve për kryerjen e veprës penale, mënjanimi i pengesave për kryerjen e veprës penale, marrveshja, planifikimi ose organizimi për kryerjen e veprës penale si dhe veprime tjera me të cilat krijohen kushte për kryerjen e drejtëpërdrejt të veprës penale por të cilat nuk përbëjnë veprimin e kryerjes.

⁴⁵Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, Tetovë, 2018, fq.174

Në fazën e tantativës subjekti kalon në veprime aktive dhe të drejtëpërdrejta për realizimin e veprës penale, me qëllimin kryesor për ta përfunduar atë në momentin e parashikuar.

Ndërsa në fazën e përgaditjes subjekti krijon kushtet e domosdoshme për realizimin e elementeve përbërse të veprës penale.

Veprimet e kryera në fazën e përgaditjes nuk mund të cenojnë mardhëniet juridike, por janë veprime të cialt ndihmojnë autorin në fazën e tantativës të ndërmarrë ato veprime të mëtejshme për të realizuar veprën penale të plotë.

Dallimi midis tantativës, dhe veprimeve përgaditore në praktikë nuk paraqet vështërsi të madhe, p.sh nëse një grup personash formojnë organizatë kriminale me qëllim të kryerjes së veprës penale të trafikimit me njerëz (neni 418), ose vepër penale të gjenocidit (neni 403), atëherë është fjala për veprimet përgaditore e jo për tantativën e kësaj vepre penale, meqense edhe në këto vepra penale sipas kodit penal të RM-së edhe veprimet përgaditore janë të dëshkueshme.⁴⁶ Mirëpo, nëse subjekti shkrep me armë në drejtim të personit që dëshiron që ta privoj nga jeta e nuk e godet, atëherë për praktikën gjyqsore është shumë e qartë se në këtë rast nuk është fjala për veprimë përgaditorë por për fiilimin e kryerjes së veprës penale, përkatësisht për tantativën e veprës penale të vrasjes.

Për praktiken gjyqsore edhe pse dallimi ndërmjet ktyre dy fazave paraprake të veprës penale siç është tentativa dhe veprimi përgaditor nuk paraqet shumë vështërsi për tu dalluar, mirpo në praktikë hasen edhe disa problematika disa raste më specifike ku nuk është edhe e lehtë të jepet përgjigje në pyetjen se a është fjala për veprim përgaditor apo për tantativë të veprës penale, në rastin kur personi ka dashur të nxjerrë revolen me qëllim që ta vrasë tjetrin, mirëpo revolja i ngatohet në këllëf dhe nuk mund ta nxjerë.

Vështërsi të mdha lindin në dallimini në mes të tantativës dhe veprimit përgaditor kur veprimet përgaditore janë shumë të afërta apo kufizohen me tantativën.

Në të gjitha rastet kur veprimet përgaditore janë shumë afër me tantativën, duke marë parasysh figuren e veprës penale konkrete, në mënyrë komplekse të vlersohet situata kriminale që është krijuar. Duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret. Së pari duhet të merrët për bazë lidhshmëria natyrale e veprimit të ndërmarrë me veprimin e kryerjes së figurës përkatëse të veprës penale. Më pasë duhet të merret për bazë plani i

⁴⁶ Kodi Penal i RM-së, Shkup, 2015

personit për kryerjen e veprës penale dhe së treti, duhet që në bazë të situatës konkrete, të konstatohet se a është fjala për sulmin në të mirën e mbrojtur.⁴⁷

a) Sa i përketë kriterit të parë, në rastet e kufizimit të ngushtë të veprimeve përgaditore dhe tentativës, ekziston rregulla që veprimet e kryerjes së veprës penale, pra si tentativë duhet të konsideruar edhe ato të cilat marrë objektivisht, mund të kualifikohen si pjesë përbërse të figurës së veprës penale të caktuar. Me veprimin e kryerjes apo si tentativë duhet konsideruar ato veprime që përbëjnë pjesë integrale, që përbëjnë pjesë të tërësisë e që janë pjesë e relizimit të figurës së veprës penale konkrete. P.sh. marrja në shenje me revole në situatën e caktuar mund të jetë pjesë përbërse e veprimit të kryerjes, pra tentativë e veprës penale të vrasjes.

b) Kriteri i dytë, që mund të shërbejë për dallimin e veprimeve përgaditore nga tentativa, është marrja për bazë e planit për kryerjen e veprës penale të caktuar. Rëndësia e planit për dallimin e këtyre dy fazave të kryerjes së veprës penale konsiston në faktin se në disa raste vetëm po që se meren parasysh suazat e tërësishme të planit konkret për kryerjen e veprës penale përkatëse, mund të konstatohet se a është fjala për veprimin përgaditor apo për tentativë.

c) Si kriter i tretë është se duhet të merret parasysh situata konkrete për dallimin e veprimeve përgaditore nga tentativa në bazë të një qasje objektive. Përkatësisht, duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat konkrete dhe në bazë të tërësisë dhe lidhshmërisë së tyre të konstatohet se a është fjala për veprimet përgaditor apo për tentativë të veprës penale.

d) Nga gjithë kjo mund të konkludojmë se për të përcaktuar nëse kemi veprime përgaditore apo tentativë të veprës penale, duhet të vlerësohen me kujdes të madh jo vetëm karakteristikat e jashtmetë veprimeve ose të mosveprimeve të kryera nga personi, por dhe se çfarë ka dashur të arrijë me ato veprime ai person, pra duhet që të shikohet edhe ana subjektive e figurës së veprës penale.

Salihu Ismet, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, fq 346

3.2. Dallimi i tentativës së veprës penale nga vepra penale e plotë

Tentativa si një nga fazat paraprake të veprimtarisë kriminale dallon nga vepra penale e plotë. Dallimi më i plotë midis veprës penale të plotë dhe asaj të mbetur në fazën e tentativës qëndron në atë, që për të pasur figurën e veprës penale të plotë kërkohet medomos ardhja e pasojave shoqërore të rrezikshme të parashikuara dhe të dëshiruara prej autorit të veprës penale, ndërkohë që në veprën e mbetur në fazën e tentativës, pasoja nuk vjen për shkaqe të pavarura nga vullneti i subjektit.

Në veprën e mbetur në fazën e tentativës rezultati shoqërisht i rrezikshëm i parashikuar dhe i dëshiruar nga subjekti nuk vjen p.sh. me synimin për të kryer veprën penale të vjedhjes, subjekti ka kryer veprimet e nevojshme për të vënë në dorësi të plotë materialet, kapet në flagrancë dhe kështu ndonëse ai drejton veprimet e tij për kryerjen e plotë të veprës së nisur, por ajo nuk përfundon.

Dallimi i ktyre dy fazave qëndron edhe në faktin se vepra penale e mbetur në fazën e tentativës nuk prek raportete shoqërore të vendosura e të mbrojtura me dispozita ligjore në fuqi, por vetëm krijohet rreziku i prishjes së tyre, kuresë në veprën penale të plotë marrëdhënia shoqërore e vendosur jo vetëm që preket por edhe prishet në tërësi

3.3 RASTET E POSAÇME TË TENTATIVËS

Tentativa e veprës penale mundë të paraqitet edhe te veprat penale më delikate, ke ato vepra të cial kryhen në një mënyrë më të ndërlikuar.

Tentativa e veprës penale është e mundur edhe ke veprat penale të kryera në mënyr indirekte. Kryerje indirekte është ajo vepër penale e cila kryehet nëpërmjet personit tjetër që e shfritëzon si mjet për ta kryer veprën penale. Veprat penale të kryera në mënyrë indirekte ngelin në tentativë, prej momentit të ndërmarrjes së veprimit me të cilin kryerësi indirekt e sjell personin tjetër në pozicon të mjetit për të kryer veprën.

Gjithashtu tentativa është e mundur edhe te veprat penale të kryera në bashkpjesëmarrje apo bashkëkryerje, është e mundur tentativa për nxitje dhe tentativa për bashkëkryerje.

Tentativa pët nxitje është ajo nxitje e pasuksesshme, rasti i tillë është, kur nxitësi nuk ka pasur sukses që tjetërit ti krijojë vendim për të kryer vepër penale.⁴⁸

Çështja e përcaktimit nëse është fjala për tentativën apo për veprimet përgaditore duhet të zgjidhet për çdo rast konkret, veçmas duke marrë parasysh veprën penale të caktuar, natyrën dhe karakteristikat e saj.

Tentativa e veprës penale mund të shprehet edhe në rastet e veprave penale formal.

Kështu p.sh. do të konsiderohet se është kryer tentativa e veprës penale të dhënies së dëshmis së rreme (neni 367), nëse dëshmitari ka filluar të jep dëshminë e rreme, por marrja në pyetje e tij nuk është përfunduar nga se duhet të vazhdohet në seancën e ardhshme gjyqësore.⁴⁹

Për rastet e veprave penale të përbëra të cilat konsiderohen se kryhen me ndërmarrjen e dy apo më shumë veprimeve, siç është vepra penale e dhunimit, konsiderohen se është kryer tentativa e kësaj vepre me faktin e vetëm të përdorimit të dhunës apo kanosjes me qëllim të kryejës së aktit seksual.

Në rastet e veprave penale të cilat siaps ligjit kryhen me veprime alternative, tentativa konsiderohet se kryhet me faktin e ndërmarrjes së njërës nga veprimet alternative apo disa prej tyre. Ndërsa në rastet kur veprimin e kryerjes nga e cila do të shkaktohet pasoja, duhet ta ndërmarrë viktimën, konsiderohet se egziston tentativa nëse është ndërmarrë ai veprim i cili duhet ta shpjerë viktimën që ta ndërmarr veprimin e kryerjes. Kështu p.sh. do të konsiderohet se është kryer tentativa e vrasjes nëse është vendosur ekspolzivi i cili duhet të aktivizohet me veprimin e subjektit pasiv (viktimës) me ndezjen e motorit.

Tentativa e veprës penale është e mundur edhe te Delikti garantues omusiv (kur garanti lëshon obligimin e tij garantues), p.sh nëna nuk e ushqen fëmijën me qëllim që ta vërasë, por fëmija është shpëtuar nga të tjerët. Tentimi i deliktit të vërtet omusiv mundë të paraqitet në formë të tëntimit të papërshtatshëm.⁵⁰

⁴⁸ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, Tetovë, 2018, fq. 177

⁴⁹ Po aty

⁵⁰ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.177

3.4 Nocioni dhe natyra juridike e heqjes dorë nga tentativa e veprës penale

Egziston rasti që dikush të ket ndërmarrë tentativën me qëllim të kryerjes së veprës penale, mirëpo përkundër faktit se mund edhe ta kryejë veprën penale, vullnetarisht heq dorë, abstenon nga kryerja e veprës të cilën ka dëshiruar që ta kryej. Kto raste në të drejtë penale quhen heqje dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale.

Kryersi i cili e ka përgaditur ose ka tentuar të kryejë vepër penale por në mënyrë të vullnetshme është tërhequr nga kryerja, mundë të lirohet nga dënimi sipas Kodit Penal të Maqedonisë.⁵¹ Heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale është bazë fakultative për lirim nga dënimi. Lidhur me këtë, shumica e Kodeve penale të shteteve bashkohore, për situatat e këtilla parashohin që kryersi i cili vullnetarisht heq dorë nga kryerja e veprës penale mund mundë të lirohet nga dënimi. P.sh Kodi penal i Kosovës neni 30.⁵²

Nga kjo rezulton se heqja dorë dueht të jetë vullnetshme, përkatësisht që vetë kryersi të vendosë të mos e kryejë veprën, edhe pse ai e di se veprimin që e ka nisur mund ta përfundoj dhe që të shkatoj pasojën e nadalur në botën e jashtme.

Heqja dorë vullnetare më së shpeshti vjen në shprehje kur është fjala për kryersin e vetëm të veprës penale. Por nuk përjashtohet mundësia që heqja dorë vullnetare të vijë në shprehje edhe në rastet e bashkpunimit, përkatësisht nga shtytësi, ndihmësi dhe bashkëkryersi.

Për ta kuptuar se a është fjala për heqjen dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale është çështje faktike të cilën gjykata duhet ta konstatojë në çdo rast konkret sipas kushteve të parapara me ligj dhe postulateve të shkencës së të drejtës penale.

Nga dispozita e nenit 21 të Kodit Penal të Maqedonisë shihet qartë se heqja dorë nga kryerja e veprës penale është bazë fakultative për lirim nga dënimi, edhe kodet penale të shteteve bashkëkohore, për rastet e tilla kanë parapar që kryersi i cili vullnetarisht heq dorë nga kryerja e veprës penale mundë të lirohet nga dënimi.

⁵¹ Kodi Penal I RM-së, Shkup 2015, neni 21

⁵² Kodi penal i Kosovës, Prishtinë, 2016

Heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale mundë të shprehet në dy forma, varësisht se a është fjala për tentativën e përfunduar apo të papërfunduar.⁵³

Ndryshe nga Kodi ynë penal, Kodi penal i Zvicrës heqjen dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale e shpreh në dy teori, heqja dorë vullnetare nga tentativa e pakryer dhe heqja dorë vullnetare nga tentativa e kryer.⁵⁴ Kodi penal i Kroacisë nuk parasheh këto dy lloje të heqjës dorë vullnetare nga tentativa.

a) Heqja dorë vullnetare nga tentativa e papërfunduar shprehet në rastet kur kryersi me vullnetin e tij të lirë ndal veprimin e mëtejshëm, pushon së vepruari, ndërpret aktivitetet e mëtejshme. Përshembull, kryersi i cili e ka rrëzuar viktimën me qëllim që ta privoj nga jeta me thikën që mbanë në dorë, heqë dorë, dhe nuk e qëllon. Në këtë situatë heqja dorë konsiston në ndërprerjen e veprimeve dhe kjo mjafton ngase për shkakë të kësaj ndërprerje nuk shkaktohet pasoja.⁵⁵

b) Heqja dore vullnetare nga tentativa e përfunduar shprehet në rastet kur kryersi pasi që të ketë përfunduar veprimin, ndërmerr një veprim tjetër me të cilin pengon shkaktimin e pasojës. Përshembull, dikush i qet tjetrit në ushqim dozë vdekjeprurëse të helmit, mirëpo mënjëher rreagon që ta parandaloj shkaktimin e pasojës së vdekjes, ja jep kundërhelmin apo dërgon viktimën në spital. Siç shihet, te tentativa e përfunduar heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale kinsiston në ndërmarrjen e kundërveprimit me të cilin parashihet shkaktimi i pasojë. Parandalimi i pasojës mund të jetë rezultat i vetë angazhimit të kryersit, ose me veprimin e personit të tretë i cili ka ndihmuar që të parandalohet pasoja p.sh. kryersi pasi e dëmton viktimën e thëret në ndihmë mjekun. Kurë parandalimi i pasojës bëhet me intervenimin e personit të tretë, kjo duhet të vijë me vendim dhe iniciativë të kryersit. Nëse pengimi i shkaktimit të pasojës bëhet nga personi tjetër pa dijen e kryersit, apo kundër vullnetit të ti, në këtë rastë nuk do të konsiderohet se egziston heqja dorë vullnetare.⁵⁶

Heqja dorë vullnetare nga tentativa e përfunduar është e mundur vetëm ke veprat penale matriale të cilat me kryerjen e tyre shkaktohen pasojat. Te veprat penale formale, të cilat konsiderohet se kryen pa u shkaktua pasoja nuk ka çka të parandalohet, te veprat formale

⁵³ Kambovsi Vllado, E Drejta Penale, Shkup, 2010, fq 340

⁵⁴ Kodi Penal I Zvicrës neni 21,2018 (Schweizerisches Strafgesetzbuch)

⁵⁵ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetov, 2018, fq. 182

⁵⁶ Po aty

heqja dorë vullnetare është e mundur vetëm në rastet e tentativës së metë. Gjithashtu heqja dorë nga tentativa nuk është e mundur te deliktet temporale dhe momentale.

Nuk dotë konsiderohet se egziston heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale nëse kryersi ka ndërmarrë të gjitha masat me qëllim që të parandalojë shkaktimin e pasojës, mirëpo përkundër kësaj pasoja është e shkaktuar. Përshembull, kur kryersi i jep viktimëse dozë vdekjeprëse të helmit dhe më pas pendohet për veprimin dhe ja jep kundërhelmin apo e dërgon në spital viktimin, mirëpo përkundër përpjekjeve për ta parandaluar pasojën, porë përsëri shkaktohet pasoja e vdekjes. Në rastet e këtilla kurë veprimet e kryersit kan pasur për qëllim parandalimin e pasojës së ndaluar. këto veprime mundë të merren si rrethana lehtësuese gjatë matjes së shqiptimit të dënimit.

Heqja dorë nga kryerja e veprës penale duhet të jetë e vullnetshme. Heqja dorë konsiderohet e vullnetshme nëse kryersi me vullnetin e vetë të lirë abstenon nga përfundimi i veprës penale, edhe pse kryersi është i vetëdëshëm dhe nuk haset në asnjë pengesë për të përfunduar veprën, por e shpreh vullnetin e vetë të lirë që të abstenoj nga kryerja e veprës penale. Lidhur me këtë është e njohur Formula e penalistit gjerman - Rajnahr Frankut, sipas të cilit heqja dorë egziston në rastet kur kryersi i thotë vetit: nuk do ta përfundojë veprën penale, edhe pse do të mundem apo mundem ta përfundojë veprën penale, por nuk dua.⁵⁷

Nuk do të konsiderohet heqja dorë e vullnetshme kur kryersi abstenon apo kur kryersi heq dorë nga përfundimi i veprës penale, për shkak të ndikimit të rrethanave të jashtme, p.sh. kurë kryersi futet në shtëpinë e viktimës për të vjedhur të hollta, por kryersi nuk mund thyejë kasafortën në të cilën gjenden të hollat, ose një rastë tjetër kur personi tentonë të përvetsoj sendin e luajtëshëm në mënyrë të kundërligjshme, pra me anë të vjedhjes kryersi pasi afrohet shumë afër kryerjes së veprës penale e vëren se vendi është nën mbykqirjen e kamerave, dhe heq dorë. Gjithashtu nuk do të konsiderohet heqja dorë vullnetare në rastet kur kryersi abstenon nga kryerja e veprës penale sepse ajo nuk do të sjell dobinë që e ka paramenduar, p.sh. kryersi futet në shtëpinë e huaj me qëllimin që të vjedhë diçka, por sheh që në shtëpi gjenden vetëm sendet të pavlefshme. Nuk do të konsiderohet heqja dorë vullnetare kur kryerësi përkohësisht ndëpret veprimin e kryerjes me qëllimin që pas një kohe ta vazhdojë,

⁵⁷ Kambovski Vllado, E Drejta Penale, Shkup, 2010, fq 341

p.sh. për kryerjen e vjedhjes kryetësi sotë heq disa tulla nga muri i depos dhe nërpret veprimin me qëllim që ta vazhdojë të nesërmen.

Motivet nga të cialt kryerësi heq dorë nga kryerja e veprës penale mund të jenë të ndryshme, mirëpo për të drejtën penale nuk janë të rëndësishme. Kryerësi heq dorë vullnetare nga motivet e natyrës morale, kurë kryerësi ka marë veprimin e kryerjes e më pasë heq dorë ngase i dhimbëset viktima. Po gjithashtu do të konsiderohet se kryerësi ka heq dorë vullnetarisht edhe në rastet kur kryerësi tërhiqet nga veprimet e vazhdueshme për shkak të frikës nga dënimi.

Motivet e heqjes dorë vlersohen dhe merrën parasysh me rastin e matjes së dënimit, në ato rastet kur është përcaktuar se kryerësi me rastin e heqjes dorë vullnetare do të denohet për ato veprime të cialt përbëjnë vepër tjetër penale të veçant të pavarur. Me këtë situat më së shpeshti ndodhemi ke tentativa e cilësuar për të cilën folëm më sipër. Këtu në faktë janë në pyetje situata kur kryerësi heq dorë vullnetarisht, mirëpo me atë rast në bashkimin idela apo fiktiv i realizohen tiparet e ndonjë veprë penale tjetër.

3.4.1 Heqja dorë vullnetare nga tentativa e veprës penale e kryer me bashkëpjesëmarrje

Me bashkëpjesëmarrje kuptojm kurrë dikush kontribon me paramendim që tjetri të kryej vepër penale. Një person që të jetë bashkëpjesëmarres në një vepër penale ai duhet të kontribojë në atë vepër si shtytes, ndihmës dhe bashkëkryes.

Heqja dorë vullnetare do të thotë refuzimi i pjesëmarrësit nga realizimi i veprës dhe neutralizimi i kontributit të tij në realizimin e pjasojës penalo juridike.⁵⁸ Si kusht i përbashkët për heqjen dorë të bashkëpjesëmarrsëve është që heqja dorë të jetë vullnetare.

Tek heqja dorë vullnetare e bashkëpjesëmarrsit egzistojn dy situata: bashkëpjesëmarësi të heqë dorë nga aktiviteti i tijë, nga veprimi i tijë, dhe që të pengojë tjetërin që kryen vepër penale.

Edhe pse nga heqja dorë e bashkëpjesëmarrsit shkaktohet mosrealizimi i pasojës, mosrealizimi i veprës së planifikuar. Sipas Kodit penal të Maqedonisë relevante është vetëm

⁵⁸ Kambovsi Vllado, E Drejat Penale, Shkup, 2010, fq 403

heqja dorë e shytësit, i cili ka hequr dorë nga tentimi i shytjes, sepse heqja dorë e ndihmësit nuk ka rëndësi sepse sipas Kodit Penat të Maqedonis tentimi i ndihmës nuk dënohet.

Edhe pse bashkëpjesëmarrësi është tërhequr, por pasoja është shfaqur në botën e jashtme, sipas ligjit nuk egziston heqje dorë vullnetare, sepse heqja dorë duhet të jetë serioze, bashkëpjesëmarrësi duhet seriozishtë të tentoj të pengoj kryerjen e veprës penale.

KAPITULLI I KATËRT

4. RASTET NGA PRAKTIKA GJYGJËSORE E TENTATIVËS SË VEPRËS PENALE DUKE PËRFSHIRË PROFILIN E KRYERSIVE TË VEPRAVE PENALE

Në këtë kapitull janë paraqitur të dhëna statistikore lidhur me kryerësit e veprës penale të mbetur në tentativë në teritorin e komunës së Tetovës, gjithashtu do të bëjë hulumtimin e rasteve të zgjidhura me procedurë penale. Të dhëna të mbledhura nga arkiva e prokuroris themelore në Tetovë dhe nga arkiva e gjykatës themelore në Tetovë.⁵⁹

Profili i kryersive të veprave penale të ngelura në tentativë


Fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave dhe paraqitjes së kriminalitetit.⁶⁰ Gjatë hulumtimit që kam bërë kam treguar për profilin e kryersive të veprave penale pikrisht për moshën, gjendjen martesore dhe sociale të tyre.

Mosha, është karakteristik e rëndësishme e fenomenit kriminal. Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore si dhe nga shënime të kërkimeve empirike kriminologjike, tregojnë se me veprime dhe sjellje kriminale merren kryesisht moshat e ndryshme pikrisht nga mosha 18-60 vjeç. Në të dhënat nga praktika gjyqësore, del se grupe të tilla të moshave të kryerësive të veprave penale të ngelura në tentativë, paka shumë janë të njëjta në të gjitha veprat penale të ngelura në tentativë.

Prej vitit 2013 deri në vitin 2018 nga aktgjykimet e bëra në gjykatën themelore në Tetovë, mosha e kryersive të tentativës së veprës penale është si në tabelën vijuese:

⁵⁹Të dhëna nga prokuroria themelore, Tetovë

⁶⁰ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq.115



■ Mosha e kryesive të veprës penale të ngelure në tentativë


Nga këto të dhëna të paraqitura në tabel, del të jetë se mosha 21- 29 është mosha e cila është më aktive në shoqëri, edhe moshat e tjera nuk janë të përjashtuar nga rastet e tentativës.

Gjinia, nga të dhënat të marra nga praktika gjyqësore në gjykatën themelore në Tetovë tregojn se kryerësit e veprave penale të ngelura në tentativë në mënyrë absolute janë të gjinis mashkullore.




Nga ilustrimi i bërë, shihet se në territorin e Tetovës në periudhën 2013- 2018 pesonat e gjinis mashkullore 100% janë paraqitur si kryerës të tentativës së veprës penale, ndërsa gjinia femrore në këto raste është paraqitur si viktimë.

Gjendja martesore, me status martesore nënkuptojmë atë se çfarë gjendje civile ka pasur kryerësi veprës, është me rëndësi të trajtohet edhe statusi familjar, përkatësisht gjendja martesore. Gjatë hulumtimit tim që kam bërë nga praktika gjyqësore në të gjitha rastet që janë paraqitur të tentativës së veprës penale kamë mësuar se çfarë statusi martesor kishin kryerësit. Tani do të paraqes një grafik dhe do të kuptojmë saktësisht statusin martesor të të gjithë kryerësive të tentativës së veprës penale.



Nga grafiku i mësipër shihet qartë se numri më i madhë i rasteve të tentativës është kryer nga kryerësit të cilët kishin statusin e martuar vërtet, në rëndë të dytë hynë personat e pa martuar, ndërsa nuk ka pasur asnjë rast të tentativës së veprës penale nga persona me status të shkurruar dhe nga personat e vija.

Gjendja sociale, ka dominuar mendimi se kriminaliteti është karakteristik për shtresat e ulëta, por praktika jonë tregon të kundërtën, gjatë hulumtimit tim ka vërejtur se kryerës të veprës penale kanë qenë të gjitha shtresat shoqërore, por pikërisht dominonte shtresa e mesme



4.1 Rastete e paraqitura të tentativës së veprës penale në Prokurorin themelore në Tetovë.

Në fillim kam dhënë një spjegim të shkurtë lidhur me prokurorin dhe rolin e saj që ka si subjektë themelor në procedur penale.

Duke u bazuar në paraimin akuzator, sipas së cilës nuk ka gjykim pa paditës, procedura penale nuk mund të zhvillohet pa akuzë të paditësit të autorizuar (nema index sine actore).⁶¹

Prokuroria ka oblikim të bëj ndjekjen e kryerësive të veprave penale, për të cilat ndjekja ndërmeret me detyrë zyrtare⁶²

Në interes të fitimit të panoramës së plotë të rasteve të tentativës së veprës penale kam bërë mbledhjen e rasteve të mara nga prokuroria themelore në Tetovë.

Në vazhdim do të jap pasqyrën e rasteve të veprave penale të mbetura në tentativë.

Në prokurorin themelore në Tetovë janë paraqitur disa lloje të veprave penale por nga hulumtimi që kam bërë dominojn veprat penale kundër jetës dhe trupit **neni 123**, veprat penale kundër pasurisë **neni 235** dhe vepra penale kunder nderit dhe moralit **neni 186**.


Por numri i rastetve të paraqitura në prokurori është shumë më i vogël në krahasim me rastet që ndodhin në realitet. Zakonishtë kto raste nuk paraqiten shumë në organet kompetente dhe për këtë shkakë nuk dihet numri i saktë i veprave penale të ngelura në tentativë.

Sipas statistikave të Ministrisë së Punëve të brendshme që nga viti 2013 kanë ndodhur 20 vrasje, por 6 nga të cilat kanë ngelur në tentativë, ndërsa që nga viti 2013 janë kryer 112 raste të vjedhjeve 15 kanë qenë të mbetura në tentativë, ndërsa vepra penale kundër nderit dhe moralit janë kryer 13 vepra, 7 nga të cilat kanë ngelur në tentativë.

Këto vepra janë kryer në Tetovë dhe rrethinë.

⁶¹ Ejup Sahiti, Ismail Zejneli, Edrejta e Procedurës Penale e RM -së , Tetovë 2007, fq 96

⁶² Ligji i procedurës penale i RM-së neni 39



Rastet e tentativës së veprës penale të mara nga prokuroria themelore Tetovë.⁶³

Sipas të dhënave të prokurorisë themelore Tetovë, në vitin 2014 kemi pasur më shumë rastet të veprave penale të ngelura në tentativ, krahasuar me vitet e tjera, në vitin 2016 ka pasur rënje të tentativës së veprës penale por kjo nuk do të thotë se ka pasur rënje kriminaliteti, është problemi se këtu kemi raste më shumë të veprave penale të përfunduara.

4.2 Rastet e zgjidhura me Procedur Penale në gjykatën themelore në Tetovë

Në Gjykatën themelore në Tetovë nga viti 2013 deri në vitin 2018 janë paraqitur 28 raste të tentativës së veprës penale me procedur penale nga 28 rastet deri më tani janë zgjidhur 24 raste ndërsa për 4 raste ende mbahen seanca gjyqësore. Nga 24 rastet e zgjidhura me procedurë penale, unë si rast studimi kam marrë vetëm 2 raste të tentativës së veprës penale të zgjidhura me procedur penale. Rasti i parë ka të bëjë me tentim vrasje, ndërsa rasti i dytë është tentim vjedhje.

⁶³ Të dhënat janë marrë nga Prokuroria Themelore në Tetovë, për qëllim të hulumtimit

Rasti i parë - tentim vrasje

Më datë 19.10 .2014. rreth orës 09:00 në vendin x në fshatin Tenovë Kryersi E.U dhe D.U babë e birë kanë kryer vepër penale nga neni 123 paragrafi 2 në lidhje me nenin 19 dhe nenin 22 të Kodit penale. Kryerësi E.U në fillim ka pasur zënkë verbale me viktimën B.Z, 15 metre ma largë ka qenë kryerësi tjetër D. U, ku dhe më paas edhe ky është bashkangjitur Zënkës. Dhe nga zënka verbale situata fillon dhe keqësohet ku kryersësi D.U fillon sulmin fizik ndaj B.Z, ku me mtejtë të rëndë e ka goditur në pjesën e kokës.Gjykata e themelore e Tetovës me vendimin **KO.br.228/15** me datë 31.08.2015 kundër të akuzuarve D.U dhe E.U nga fshati Temovë të ngarkuar me veprën penale tentim vrasje të parapar me nenin 123 paragrafi 2 lidhur me nenin 19 dhe 22 të Kodit Pena, ka marë vendim që të akuzuarit ti dënoj me dënim 1 vitë burgë.⁶⁴

Arsyetim i dënimit. Edhe pse vepra penale në parim nuk na lën përshtipjen e tentativës së veprës penale, më së shumti i ngjan një vepre tjetë penale, pikrisht veprës penal lëndim i rëndë trupor, por qëllimi i kryersive ka qenë që ta privojn nga jeta viktimen ,dhe duke parë qëllimin e kryersive Gjykatsi J.V i dënon për tentim vrasje.

Rasti i dytë - tentim për vjedhje

Më datë 06.02.2017 rreth orës 01 të mesnatës në një Bastore Sportive në Tetovë kryerësi M.S ka tentuar të futet në bastore duke tentuar të hapë me forcë derën ka përdorur mjetë të forta, kryerësi mbasë 5 minutave tentim që të hapë derën vëren se ka kamera sigure dhe largohet nga vendi. Në këtë rastë vepra ka ngelur në tentativë se ka vërejtur kamerat e siguris dhe është frikësuar, se në të kundërtën do ta kryente veprën. Por në këtë raste i akuzuari thot se ka bërë heqje dorë vullnetare nga vepra, por faktet e tregojn të kundëtën, kryerësi shikon kameran e sigurisë dhe ndalon tentimin për tu futur në Bastore.Për këtë vepër penale me vendimn gjygjësor me nr **KO.br.445\2017** gjykata ka marë vendim dhe ka dënuar kryerësin me dënim 1 vit burgim, gjykata ja ka shqiptuar këtë mas të dënimit duke u bazuar në kodin penal dhe duke shiquar dosjen e kryersit ku kryersi para disa viteve kish kryre të njejtën vepër penale, do të thot se kryerësi është recitivist⁶⁵.

⁶⁴ Të dhënat janë reale, të mara në arkiven e gjykatës themelore në Tetovë,

⁶⁵ Po aty,

Arsyetim i dënimit. Gjykatësi N.I ka marrë këtë vendim duke u bazuar në nenin 235 paragrafi 4. Arsyeton dënimin se kryersi do ta përfundonte veprën sikur të mos kishte vërejtur kamerat e siguris, duke marrë parasyshë se ky rerësi isht i njohur për organet e shtetit.

Konkluzion im rreth këti vendimi: Prokuroria dhe Gjykata këtë vepër penale e kanë cilsuar si tentim vjedhje por duke analizura se në çfar rrethanash është kryre vepra penale kjo vepër penale duhet të cilsohet si tentim i vjedhjes së rëndë, duke u bazuar në nenin **236 paragrafi 1**. Në këtë rast kryersi ka tentuar me dhunë të hapë haspsirën e mbyllur. Duke parëmasën e dënimit të shqiptuar është meritor kundërejt veprës.

4.3 Evidenca statistikore nga Enti Statistikor Republikan

Sipas Entit statistikor të Republikës së Maqedonis, në Maqedoni në periudhën prje vitit 2013 deri në vitin 2018 janë kryre këto tentativa të veprës penale, ku sipas Entit statistikor të Rm-së janë ndarë në 8 regjione.

Tabela nr1. Tentativae e veprës penale të vrasjes në RM-së periudha 2013-2018⁶⁶

Në territorin e Maqedonisë nga viti 2013 deri në vitin 2017, sipas statistikave të mara nga enti statistikor rebublikan, kanë ndodhur 75 raste të tentim vrasjës.

Qyteti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Tetovë	0	2	1	0	2	1
Shkup	4	6	3	5	3	4
Oher	2	1	1	0	2	1
Kumano v	1	3	1	2	2	1
Manasat ir	0	2	1	2	3	0
Veles	1	1	2	2	1	1

⁶⁶ Të dhëna të mara nga Enti Statistikor i Rm-së për periudhën 2013- 2018

Strumica	1	4	2	\	1	1
Shtip	\	1	1	\	2	\
Gjithëse	9	21	12	11	16	9

Duke analizuar tabelën e të dhënave vërejmë se në vitin 2014 dhe 2017 ka pasur më shumë tentim vrasje, Duke analizuar nëpër Qytete vërejm se në Shkup ka pasur më shum tentim vrasje gjithëse 25 ku më pas rëndite Kumanova me gjithëse 10 tentim vrasje ndërsa Tetova dhe Gostivari kan numrin e njejtë të tentim vrasjeve nga 6 tentime, ndësa qyteti i Shtipit kryeson në qytetin me më pak raste të tentim vrasjeve në Republikën e Maqedonisë me gjithëse 4 raste të paraqitura.

Tabela nr2. Tentativa e veprës penale të vjedhjes në Rm-së në periudhen 2013-2018⁶⁷

Në territorin e Maqedonisë nga viti 2013 deri 2018, sipas statistikave të marra nga Enti statistikor, kanë ndodhur 189 raste të tentativës së veprës penale të vjedhjes.

Qyteti	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Tetov	4	2	3	1	2	3
Shkup	11	7	13	14	17	14
Ohri	3	1	4	3	2	3
Kumano v	4	6	3	3	5	4
Manastir	3	2	3	5	3	2
Veles	2	4	1	3	2	2
Strumica	1	3	1	4	3	2
Shtip	2	4	1	1	3	2
Gjithëse	30	29	29	34	37	30

⁶⁷ Po aty,

Kjo është një statistik e tentim vjedhjeve që posedon enti statistikor republikan, siç shihet kjo tabel është ndarë në 8 regjione. Duke analizuat tabelën e të dhënave kemi vërejtur se në Rm-së në periudhën prej 2013-deri në vitin 2018 janë regjistruar gjithë 189 raste të tentim vjedhjeve në periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2018, ku në list kryeson Shkupi me numër më të madh të restetve të parqitura për tentim vjedhje gjithse 76 raste të paraqitura, ndërsa me numër më të vogël të rasteve të paraqitura kryeson Shtipi me gjithëse 13 raste të paraqitura.

Përfundimi

Kuptimi i tentativës si fazë e kryerjës së veprës penale paraqet një interes të madh, në aspektin teorik dhe sidomos në atë praktik. E drejta penale i njeh si faza të kryerjës së veprës penale: lindjen e mendimit, shfaqjen e tij, veprimet përgaditore dhe tentativën. Lindja e mendimit me Kodin penal të RM-së nuk është e dënueshme, por kjo nuk do të thotë se ajo nuk egziston si fazë. Shfaqja e mendimit, përgjegjësisht nuk është e dënueshme, me përjashtim të rasteve kur personi që në momentin e shfaqjes së mendimit ka konsumuar veprën penale. Në lidhje me veprimet përgaditore, në kodet penale, në pjesën e përgjithshme të tyre, parashihet kuptimi i veprimeve përgaditore si dhe përgjegjësia penale për personin i cili përgaditet për të kryer një vepër. Pikpamja dominuese në Kodet penale, është se veprimet përgaditore për disa lloje të veprave penale janë të dënueshme, pikrisht veprat penal me karakter ndërkombëtar, tek kto vepra penale edhe faza përgaditore është e ndëshkueshme, Tentativa si fazë e kryerjës së veprës penale, objekt i punimit i paraqitur më lartë, egziston kur ndërmeren veprime të drejtëpërdrejta për të kryer vepër penale, ku kryerësi shpreh dëshirë për të kryer vepër penale do të thotë vetëm ke veprat penale ku forma e fajit është dashja, si dhe vepra mos përfundohet, pikrisht mos shkaktohet pasoja. Vepra gjithmonë duhet të mos të përfundojë kundër vullnetit të kryerësit. Tentativa si fazë e kryerjës së veprës penale si problematikë është cekur që në kohrat e mëhershme, pikrisht këtë problematikë e sqaron Kanuni i Lek Digagjinit dhe e drejta skllavopronare. Tek tentativa e veprës penale mbizotron metoda komperative, ku secili shtet e parasheh ndryshe në kodin penal, dallimi më së shumti vrehet në ndëshkimin e kryerësive. Tentativa për tu saqaruar më saktë, ndahet në disa lloje në varësi të rrethanave që janë krijuar për atë tentativë, kemi kto lloj të tentativave: Tentativa e plot, e met, tentativa e papërshtatshme absolute dhe relative dhe tentativa e cilsuar. Gjithashtu egzistojnë disa vepra penale ku kjo fazë e kryerjës së veprës penale nuk është e mundur të krijohet, sepse ato vepra konsiderohen se janë kryer drejtëpërdrej, konsiderohet së është kryer vepra penale nëse është ndërmarë veprimi përgaditor p.sh tek vepra penale e gjenocidit. Tentativa dallon nga fazat tjera të veprës penale, secila nga fazat ka karakteristika e veta specifike.

Tentativa mundë të paraqitet edhe të vepra penale më të ndërlikuara, edhe pse është e vështirë, por tentativa është e mundur edhe të veprat penale të kryera në mënyrë indirekte, gjithashtu

tentativa mund të kryhet edhe te vepra penal të përbëra. Është e mundur edhe heqja dorë nga tentativa e veprës penale, por kjo egziston vetëm atëher kur kryersi në mënyrë vullnetare heq dorë nga vepra penale, nëqoftë se ka qënë në ndikim të rrethanave atëhrë nuk kemi të bëjmë me heqje dorë. Heqja dorë është e mundur edhe te veprat penale të kryera me bashkëpjesëmarrje. Tentativa si fazë e veprës penale është e dënueshme me çdo legjislacion kombëtar. Maqedonia e ka të rregulluar me Kodin penal në nenin 19 dhe 22. Sipas Stateistikave që posedon prokuroria dhe gjykata themelore e Tetovës, në periudhen nga viti 2013 deri në vitin 2018 janë rregjistruar më shumë rastet të tentativës së veprës penale kundër jetës dhe trupit, kundër pasuris dhe veprën penale kundër nderit dhe moralit. Në periudhen nga viti 2013 deri në vitin 2018 janë kryer gjithse 20 vrasje, 6 prej të cilave kanë ngelur në tetntativë, ndësa në po të njejtën periudh janë kryer 112 raste të vjedhjeve, 15 kanë ngelur në fazen e tentativës, kundër nderit dhe moralit janë kryer 13 vepra , 7 nga të cilat kanë ngelur në tentativë. Viti i cili lulëzon nga kryerja e ksaj faze të veprës penale në rrethin e Tetovës është viti 2014, ndërsa në vitin 2016 janë paraqitur më pak raste të tentativës së veprës penale. Por sipas statistikave të ministris së puneve të mbrendshme në viti 2016 ka pasur më shum vepra penale të kryera. Gjatë hulumtimit të punimit kam analizuar edhe profilin e kryersive të veprave penale, duke analizuar moshën e kryerësive kam vërejtur se mosha më aktive në këtë krimië është mosha 21-29 vjeç, a sipas statusit martesor dominojnë kryerësit me status të martuar martesor me 60% ndërsa kryerësit me status të pamartuar me 40%. Sipas gjinis, kryesisht dominon gjinia mashkullore me 100% të rasteve të paraqitura.ndërsa duke analizuar statusin social pikrisht dominon shtresa e mesme më pas vijonë shtresa e ulët dhe ajo e lartë. Gjatë hulumtimit të punimit kam ardhur në përfundim se tentativa si fazë e kryerjës së veprës penale nuk është e mundur tek veprat penale të kryera me mosveprim.

BIBLIOGRAFIA

I- Libra:

Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E **drejtapenalepjesa e përgjithshme**, Tetovë, 2018

Vllado Kambovski, E **drejtapenale**, Shkup 2007

Vllado Kambovski, - E **drejtapenale**, **Pjesa e posaçme**, **Shkup** 2003

Vllado Kambovski, E **drejtapenalenderkombetare**, Shkup,1998

Ismet Salihu, E **drejtapenalepjesa e përgjithshme**, Prishtinë, 2003

Ismail Zejneli, E **drejtapenalepjesa e posaçme** Tetovë, 2007

Ismet Elezi, **Zhvillimihistorik i legjislacionitpenalnëShqipëri**, Tiranë, 19998

Shefqet Muça, E **drejtapenalepjesa e përgjithshme**, Tiranë, 2007

Michael Allen, **CriminalLaw**, 2003

Ismet Salihu, H.Zhitija, F. Hasani, **Komentari i koditpenal** të Kosovës

Ragip Halili, **Kriminologjia**, Prishtinë, 2011

Ragip Halili, **Penologjia**, Prishtine,2015

Jonathan Hrring, E **drejtapenale**, 2013

Ejup Sahiti, Ismail Zejneli, E **drejta e procedurespenale e RM-së**, Tetovë, 2007

Vesel Latifi, **Kriminalistika**, Prishtine, 2016

Vesel Latifi, **Politika e parandalimit te krimit**, Prishtine,2012

Franjo Bacic, E **drejtapenalepjesa e pergjithshme**, Shkup, 1972

Zlataric Bogdan, E **drejtapenale** pjesa e **pergjithshme**, Zagreb, 1970

Zoran Stojanoviq, E **drejtapenale**, -pjesa e **pergjithshme**, Beograd, 2003

II-Burime tjera

Kodi Penal i RM-së, 2015

Kodi penal i Kosovë, 2016

Kodi penal i Shqipëris

Kodi penal i Zvicrës, 2018 - Schweizerisches Strafgesetzbuc

Ligji i procedurës penale i RM-së

Lorenc Danaj, Tema e disertacionit, Raporti i së drejtës penale me të drejtën Ndëkombëtare, Tiranë, 2012

Të dhëna të marra nga prokuroria themelore e Tetovës

Të dhëna të marra nga Gjykata themelore e Tetovës

Të dhëna të marra nga Enti Statistikor i RM-së